

**Dinamika gjuhësore në zonën e Adriatikut
mes shekujve XVIII-XIX: mes diglosish, dygjuhësish
dhe synimit të gjuhëve kombëtare***

**Dynamics of language in the area of the Adriatic Sea between the
18th and the 19th centuries. Diglossia, bilingualism and the quest for
national languages.**

Abstract: Not surprisingly, in the 18th century the area of the Adriatic Sea was still an area of important encounters and where ideas were exchanged. More than a geographical area, the Adriatic Sea and the countries lulled by its waves are to be considered as a sort of *situation* rather than a mere area of planet Earth. Such encounters generated in time a sort of cultural *koiné* in this area.

In his essay, Prof. Banfi centres around the pre-Romantic and Romantic debate in Italy about the Italian language. As such debate formed part of the Adriatic identity, it influenced the rise and the development of the ideas and the ideology of languages in the would-be Balkan states, especially of the Southern Slavs, Greece and Albania. Prof. Banfi clears up that such influence does not contemplate nationalism in the present-day meaning of this word but only in a more general national awakening of each of the countries bordering on the Adriatic Sea.

Keywords: Italian language, Venetian dialects, Ionian Isles, Foscolo, diglossia, bilingualism, Corfu, Austro-Hungarian empire, Slavic Balkan area, Albania, Tommaseo, Solomòs.

Për Manlio Cortelazzo
Μνήμης χάριν

1. Një kërkim rreth kuadrit gjuhësor të zonës së Adriatikut, në hapësirën kohore të kapërcyellit mes shekujve XVIII - XIX (periudhë për rëndësinë historike të së cilës do të flitet më poshtë) nuk mund të mos trajtojë dhe karakteristikat socio-antropologjike dhe funksionet e kësaj

* Me Francesco Bruni-n e diskutova paraqitjen e përgjithshme të këtij kontributi dhe nga shkrimet e tij pata një shtysë të vlefshme. Pierluigi Cuzzolin, Federica Da Milano, Gabriele Iannàccaro, Gianguido Manzelli dhe Paolo Zublena kanë qenë të vyer me vëzhgimet e përpikta. Falenderimi im shkon për të gjithë ata.

zone, qysh nga hershmëria, por veçanërisht në epokën mesjetare dhe moderne, në brendi të dinamikave gjuhësore evropiane. I quajtur 'Gjiri i Venedikut'¹ për supremacinë e pakundërshtuar për një kohë të gjatë të Republikës së Venedikut (*La Serenissima*²), apo madje i shënuar në kodet e

- 1 R. CESSI, *La Repubblica di Venezia e il problema adriatico*, Napoli, 1953, f. 45-46. 'Gjiri' ishte një realitet juridik i mirëpërcaktuar, politikisht dhe ushtarakisht, i njohur si i tillë, në segmente kohore të caktuara nga vetë bashkëkohorët: gjeografi arab-andaluzian Edrisi (1110-1165) fliste për 'Gjirin e venedikasve; mbreti i Sicilisë Guglielmo II (1153-1189) detyrohej – duke përdorur një latinishtë larg modeleve klasike – të mos pushtonte terras, que sunt de tenimento ducis Venetie et Veneticorum, scilicet a Ragusa usque Venetiam; perandorët bizantinë pranonin se nuk bënin pjesë në domenet e tyre tokat në veri të Durrësit. Vetë venedikasit ishin plotësisht të ndërgjegjshëm, kur i caktonin kufijtë e 'Gjirit' *de Ragusio in Ravennam* në lindje, *de Ancona in Ravennam* në perëndim, duke përvijuar edhe funksionin e tyre ushtarak. Vincenzo Coronelli, në vëllimin e parë të veprës së tij *Biblioteca universale sacro-profana antico-moderna...* (Venezia, 1701-1718) sjell të dhënën se «Adriatiku det» me kalimin e kohës ka marrë emrin «Gjiri i Venedikut» dhe përdor shkrimin *Golfo di Venezia* ("Gjiri i Venedikut") pikërisht në pllakën, që daton 1688, që paraqitet (falë veprës së Fridrich-ut skalitës) në veprën *Atlante Veneto* (Venezia 1691) ku «kozmografi i *Serenissima*-s», në «përshkrimin» gjeopolitik të «universit», parapëlqen rolin e «Republikës gjithnjë të lavdishme», 'Gjiri' i së cilës, nëse në perëndim lag tokat papnore dhe të mbretërisë së Napolit, në lindje lag «brigjet e provincave» për më tepër, «thujtë të gjitha» me përkatësi veneciane, duke u shtyrë deri në «Shqipëri dhe Epir deri në Butrint, që ndodhet përballë ishullit të Korfuzit». Ky i fundit, është më veriori i ishujve jonianë, aty ku ishulli Cerigo është më jugori, dhe kishte vlerën e 'rojtarit të Gjirit', sipas G. BENZONI, *Sa d'Ionio la Venezia da mar*, në *Venezia e le isole Ionie*, Atti del Convegno di studio 'Venezia e le Isole Ionie' (Corfù 26-27 settembre 2002), a cura di CH. MALTEZOU - GH. ORTALLI, Venezia 2005, f. 117. Gjiri është pjesë e thelbit të Venedikut; trualli i tokës është në një farë kuptimi 'shtesë'. Ta lesh gjirin në dorë të të tjerëve, «ta hapësh për shkarpa që ndezin luftë nga jashtë» është si t'i «japësh atyre zotërimin e Venedikut». E nënkuptuar në arsyetim se Venediku pa truallin tokësor ngelet po ai, pa Gjirin jo. ENZONI, *Sa di Ionio*, f. 120 sjell një proverb të lagunës që e përmbledh mirë një ndjesi të tillë: «Chi xe paron del mar, xe paron de la tera». («kush është zot i detit, është zot i tokës»).
- 2 Supremaci e vënë në diskutim sa e sa herë nga shtetet italiane dhe të Evropës, por asnjëherë nga otomanët që e konsideronin të përligjur jurisdiksionin e Venecias mbi Gjirin 'e saj': sipas G. VERCELLIN, *Gli Ottomani in Adriatico. Intrecci e trasfusioni di cultura e tradizioni*, in *L'Adriatico: mare di scambi tra Oriente e Occidente*, a cura di M. CATTARUZZA et alii, Pordenone, 2003, f. 51, 'Gjiri' ishte «[...] i krahasuar – ashtu si deti i Marmaratës, Deti i Zi, Deti i Kuq – me ujëra të brendshme thujtë liqen, mbi të cilin shtrihej pa përjashtim jurisdiksioni i një shteti që i dominonte brigjet». Dhe, në fakt, Venecia nxitoi menjëherë të firmosë (18 prill 1454), as një vit pas rënies së Kostandinopojës në duar të turqve, një traktat paqeje me Mehmetin e II i ashtuquajtur Conquistatore ("Pushtuesi") në mënyrë që t'i siguroheshin pozicionet e privilegjit në tregtitë me Levante-n (Lindjen). Shumë tregtarë venedikas në Perandorinë Osmane, shumë tregtarë turq në Venedik, siç dëshmon qartë kompleksi i ndërtesave në dispozicion të turqve (*Fondaco dei Turchi*), ngritur mbi Canal Grande për t'i strehuar, dhe me ta, mallrat e tyre, zakonet e tyre, ndikimet e tyre artistike. Për qëndrimin e otomanëve kundrejt 'Gjirit' të Venedikut, të konsideruar si një segment shumë i vogël i Mesdheut, shih edhe G. BELLINGERI, *Il Golfo come appendice: una visione ottomana*, in *Mito e antimito di Venezia nel bacino adriatico (secoli XV-XIX)*, a cura di S.

detarisë venedikase me shprehjen *il nostro canal* (kanali ynë), në kuptimin e vazhdimet të *Canal Grande* (Kanalit të Madh) venedikas, Adriatiku – shprehje konkrete e *dominium maris*³ të Venedikut, është konsideruar

GRACIOTTI, Roma 2001, f. 14 ku është cituar thënia e sulltan Selimit I (1512-1520) në lidhje me qenien një “i tërë” të detit Mesdhe, nënkuptuar *in toto* si pronë e sulltanit: «[...] aq dengiz dëdükleri bir xalıgdür anda bu qadar müllek-i muxtelife ğem’olub temâmen bir xalığ devlet-i ‘aliyye hûkminde olmamaq lâıyîq mîdur [...]» – «[...] Ai që quajmë Deti i Bardhë është një gji i vetëm, dhe në të gjenden të grumbulluara aq shumë mbretër dhe mbretëri! Julutem, është gjë e duhur dhe e drejtë që ky gji si i tërë nuk është pronë e Portës së Lartë!? [...]» (nga *Târîx-i Ğevdet*, I, 2^o ed., Der-sa’âdet 1309/1891-92, pp. 121-122). Dhe në fakt, Kâtib Çelebî (1609-1657), *Tuhfet ül-kibâr fî esfâr ul-bihâr* (*De Geographia Liber Constantinopoli impressus ab Ibrahim Ephendi*), Hegirae 1141, BNM, Cod. or. N. XCVII (33), p. 4 definiva i Veneziani Dhe në fakt, Kâtib Çelebî (1609-1657), *Tuhfet ül-kibâr fî esfâr ul-bihâr* (*De Geographia Liber Constantinopoli impressus ab Ibrahim Ephendi*), Hegirae 1141, BNM, Cod. or. N. XCVII (33), f. 4 i quante venedikasit «[...] müstevlî oldî venedik ĩâ’ifesi gibi bir qavm-i maxdûl ki mülûk-i küffâr beyinde rütbesi dûqâ pâyesine maqsûr ve aralarında balıqçı ‘üvânî ile meşhûrdur memâlik-i mahrûsanung boĝazına gelüb şarqa ve ĝarb hûkm eylien ‘aziîm üş-şân devlete qarşı qodî [...]» – «[...] venedikasit – skuadër e padenjë endacake dhe e shpërhapur gjithandej - që mes sovranëve të pafë zunë ofiqin e ulët të *duca* “dukës”, të njohur ndër të pafë me nofkën ‘peshkatarë’, kanë mbërritur deri në ngushticën [= Ngushticat] e mbretërisë sonë fort të mbrojtur, duke iu kundërvënë një shteti me lavdi të ndritshme, mbretërues në lindje dhe në perëndim [...]». Jo më pak ‘agresive’ në fakt, qenë konsideratat nga ana e ‘Perëndimit’ në drejtim të turqve. Mjafton të përmendet si shembull, mënyra si u shpreh papa Pio II, humanisti i madh nga Pienza, Enea Silvio Piccolomini, në lidhje me faktin se, duke luajtur me asonancën *Turci* “turq”/ *Teucri* “trojanë”, disa donin që turqit të rridhnin prej trojanëve (dhe ai që kishte emër trojan, Aeneas, ishte mjaft i ndjeshëm ndaj çështjes), trojanë, të cilëve gjithsesi turqit i zinin truallin e fisëm të Azisë së Vogël. Cfr. *Cosmographia Papae Pij: Asia...*, Venetiis, per Bernardinum Venetum de Vitalibus, Anno Domini MDIII, pp. II ii v-II iiir: «[...] Ut eorum confutetur error qui gentem Troianam Turcos esse affirmant: ac Teucros vocant. Turci [...] gens truculenta & ignominiosa in cunctis stupris ac lupanaribus fornicaria comedit [...] iumentorum luporum ac vulturum carnes [...]. Nec unum quemdam principem: sed alios alii duces [...] haec est Ottomanorum progenies: & Turcorum origo: qui quamquam ea loca possident: quae olim Teucri tenuere. Non tamen Teucri appellandi sunt: [...] Scytarum gentem esse docuimus: barbaram & taetram [sic!] progeniem quamvis pluribus saeculis in Asia Graeciaque commorati vitam mitiorem induerint: & imperium utriusque terrae consecuti sint [...]». Me pasojën e kuptueshme – vëzhgon G. BELLINGERI, *Venezia, uno specchio, la ruggine. Perifrasi repubblicane intorno agli imperi ottomano e safavide*, in *Semantiche dell’impero*, a cura di A. FERRARI et alii, Napoli 2009, f. 63 – që «origjinat e Shtëpisë Otomane» do të denoncohen si «të errëta dhe të ulëta (dhe në veçanti disa metatekste të sheqerosura nuk do të funksionjnë, ose më mirë: do të qarkullojnë në kuptim të papëlqyeshëm të *Turci* “turq”> *Truci* “te egër, *Truculenti* “të pamëshirshëm”, etj.).

- 3 O. CHALINE, *L’Adriatique, de la guerre de Candie à la fin des Empires (1645-1918)*, në *Histoire de l’Adriatique*, a cura di P. CABANES, Paris 2001, f. 360 kujton disa episode emblematiche që vërtetojnë vullnetin e *Serenissima*-s për të respektuar supremacinë e saj në Adriatik: në 1630, anija spanjolle që çonte vajzën e mbretit të Spanjës (l’Infanta di Spagna) do burri i saj i ardhshëm, perandori Farnando II, u detyrua të marrë lejen e Venedikut për të përshkuar ujërat e Adriatikut dhe për të mbërritur Triesten; po kështu, në 1708, perandori Giuseppe I u detyrua të marrë leje venedikase për të

nga Braudel⁴ një lloj Mesdheu në miniaturë, që ruan nga Mesdheu në thelb karakteristikat kryesore gjeo dhe socio-antropologjike: gjatësia nga Venecia në ngushticën e Otrantos arrin në 700 km Adriatik; sipërfaqja e tij është 140000 km²; i përmbledhur në një rreth, do të kishte një diametër prej 492 km; brigjet e tij kontinentale dhe ishullore janë, përkatësisht 3887 e 1980 km; gjerësia e tij mesatare është 220 km, por zona më e afërt, ajo e ngushticës së Otrantos është vetëm 72 km: urë kalimi e parapëlqyer nga të dyja brigjet, shumë afër njëra-tjetrës.

Ashtu si Mesdheu, për Braudel-in Adriatiku është, në fakt, një 'rrafsh ujqor' tipik, një 'hapësirë e paqëndrueshme', një 'hapësirë e ndryshueshme' që thjeshtëzon kontaktet dhe marrëdhëniet mes popullatave të vendosura përgjatë brigjeve të tij: një zonë e integruar si në Mesdhe ashtu dhe në dinamikat e Evropës. I përshkuar nga tregtarë si të lindjes ashtu dhe të perëndimit, të pajisur me ngarkesa detare gjithnjë e më të mëdha (deri në anijet e mëdha të kohëve tona), zona e Adriatikut ka ruajtur raporte të ngushta me ambientin danubian; ka përjetuar bashkëpunimin rreth brigjeve të tij të katolikëve dhe myslimanëve, hebrenjve dhe ortodoksëve dhe diplomacitë ndërkombëtare kanë qenë të detyruara të mbajnë parasysh këto elemente në atë masë, sa vendimet politike në lidhje me fatet e detit dhe të brigjeve të tij, janë marrë - siç na e kujton drejt R. Simonato⁵ - në Paris, Moskë e Vjenë. J. Le Goff, nga ana e tij e quan Adriatikon një «det asimetrik»⁶; me brigjet e tij perëndimore në vijë të drejtë në kepin e Garagano-s dhe zonës së paqetë të grykëderdhjes së lumit Po dhe të lagunës së Venecias; ndërsa brigjet e tij lindore, të parregullta dhe mjaft të dhëmbëzuara, nga Trieste dhe Istria deri në Korfuz. Në pakicë portet e rëndësishme: Venecia, njëri prej tyre përgjatë periudhës së pushtetit të *Serenissima*-s; më pas, nën sundimin austro-hungarez Trieste, Pola/Pula, Fiume/Rijeka. Më thjesht funksiononin realisht portet e tjera: Raguza, nga mesjeta e deri në fillim të shekullit XIX; Ankona, port me rëndësi mesatare dhe gjithsesi në shekuj, port i Shtetit Papnor; Bari dhe Brindizi, në mesjetë, vende të ngarkimit të anijeve me pelegrinë që niseshin drejt Tokës së Shenjtë.

1.1. Adriatiku, gjithsesi, ndonëse pjesëmarrës në atë fenomen qendërikës që karakterizon zonën mesdhetare - që kish qenë për shekuj me radhë qendër e ekonomisë evropiane - përfaqësonte ende në shekullin XVIII, si

dërguar përforsime, për më tepër pa armatime, në Napoli duke kapërcyer ujërat e Adriatikut me anije për më tepër pa mbrojtje.

4 F. BRAUDEL, *Civiltà e imperi nel Mediterraneo nell'età di Filippo II*, Torino 1976, f. 118-127.

5 R. SIMONATO, *Un mare di tracce*, në *L'Adriatico: mare di scambi tra Oriente e Occidente*, a cura di M. CATTARUZZA et alii, Pordenone, 2003, f. 8.

6 LE GOFF, *Préface*, në *Histoire de l'Adriatique*, a cura di P. CABANES, Paris 2001, f.7.

për shtetet që lagte (Republikën e Venedikut, Shtetin Papnor, Mbretërinë e Napolit, Perandorinë Osmane, Republikën e Raguzës dhe Perandorinë e Habsburgut), ashtu edhe për rripat e gjerë të tokave që gjendeshin mbas tyre, sipas R. Tolomeo-s, «një hapësirë e rëndësishme takimesh dhe këmbimesh»⁷. Chaline⁸, pikërisht në lidhje me Republikën e Venedikut, duke trajtuar epokën «très long et parfois très bel automne» (një vjeshtë e gjatë, por ndonjëherë shumë bukur) të shekujve XVII - XVIII, thekson faktin se:

Venecia nuk u rrënua nga lëvizjet sociale, që sollën ulje-ngritje e shtresëzime të reja. [...] Pasuria nuk u zhduk, gjithsesi. [...]. U zhvendos veçse përftimi i saj, prej detit më në tokë. Ka gjithnjë të huaj që e gjallërojnë tregtinë. Për pjesën më të madhe të popullsisë së *Zonjës së detrave*, niveli i jetës nuk ishte në rënie. Pavarësisht pritshmërive të atyre që i kishin sytë në trashëgimninë e saj, Venecia pati aftësinë, përgjatë shekullit XVIII, ta kapërcejë situatën, falë aftësisë për të rezistuar e për t'u përshtatur, cilësi që për shumë kohë janë neglizhuar padrejtësisht nga historianët [...].

F. Farinelli⁹ parashtrohet që Adriatiku të konsiderohet si një 'gjendje' dhe jo si një vend, si një vazhdimësi e padallueshme mes tokës e detit, si një lojë - e lashtë dhe gjithnjë e rilindur - ujërash të uritura për tokë dhe tokash të etura për ujë; një botë 'e paqëndrueshme', në shërbim të shkëmbimeve, takimeve mes popujsh që dallojnë nga etnosi, gjuha, feja, kultura, të cilit i detyrohet krijimi në epokën mesjetare dhe moderne i një lloji 'koineje' kulturore adriatikase¹⁰: një realiteti të përbërë nga qytete, qyteza, kështjella që feksin në brigjet e detit përballë, ngahera të bashkuara nga lidhje dhe marrëdhënie; dhe me intensitet më të madh në kohën e dominimit të

7 R. TOLOMEO, *Rapporti commerciali tra le due sponde adriatiche dalla caduta della Repubblica veneta al Congresso di Vienna*, in *Homo adriaticus. Identità culturale e autocoscienza attraverso i secoli*. Atti del Convegno internazionale di studio (Ancona, 9-12 novembre 1993), a cura di N. FALASCHINI et alii, Reggio Emilia 1998, f. 465.

8 CHALINE, *L'Adriatique, de la guerre de Candie*, f. 374-375.

9 F. FARINELLI, *Lo spazio adriatico. Via d'acqua e cerniera*, në *L'Adriatico: mare di scambi tra Oriente e Occidente*, a cura di M. CATTARUZZA et alii, Pordenone, 2003, f. 19.

10 Realiteti i një koineje që bashkonte dy brigjet e Adriatikut ishte i gjallë qysh nga epoka mesjetare, siç dëshmojnë traktatet tregtare të firmosura mes qyteteve puljeze dhe qyteteve dalmate, qysh nga periudha e shekullit XII: ndër më të lashtat, ato të Raguzës dhe Molfetës (Molfetta), që në redaktimin e saj të parë vjen qysh nga 1148; pastaj ato që në vazhdim ndërlihdën qytetet e tjera detare puljeze – sidomos Monopoli, Bari, Bishelje (Bisceglie), Trani, Barleta (Barletta), Manfredonia (dhe, megjithëse qytet jo bregdetar, edhe Leçe (Lecce) – mes shekujve XIII - XV me qytetet e bregut tjetër. V. VALENTE, *Fortuna dell'etnico 'schiavo', 'schiavone' nelle parlate pugliesi*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 261 thekson arsyet ekonomike të këtyre raporteve dhe i quan «praktikisht përplotësuese» ekonomitë e dy brigjeve, të tilla që «[...] shtynë në mënyrë të natyrshme popullsitë dalmate dhe puljeze të kërkojnë dhe të shkëmbejnë produktet e njëra-tjetrës», aq sa (*Ibid.*, f. 261) «Dokumentet nga shekulli XIII e tutje përvijojnë një gjendje simbioze të vërtetë ekonomike».

përbashkët turko-venedikas, kur uniteti mes dy brigjeve u bë më i fortë dhe kur, për t'iu larguar trysnisë turke në zonën ballkanike, ndodhi një eksod i vërtetë i popullatës sllave (por dhe shqiptare) drejt brigjeve perëndimore të Adriatikut¹¹. Këto kushte zgjatën deri në çastin kur – në fillim të gjysmës së parë të shekullit XIX – u formuan embrionet e shteteve kombëtare ballkanike dhe me to, morën formë kufij të ngurtë, psikologjikë në radhë të parë, të cilët e vunë në krizë të vazhdueshme lidhjen në një unitet të vetëm që bashkonte dy brigjet.

1.2. Në historinë e Mesdheut – ashtu si dhe në atë të Adriatikut - brigjet janë 'tjetër gjë' përkundrejt truallit në brendësi: nuk i janë nënshtruar kurrë, përveçse në kohë shumë të reja dhe vetëm për interesa të pjesës së brendshme¹²: kanë qenë gjithnjë, për ta thënë ndryshe, pjesë më vete, të hapura siç ishin ndaj dialogut dhe bashkëbisedimit me 'të tjerët', pikërisht, sepse deti nuk ishte aspak element ndarjeje, por bashkimi. Farinelli¹³ na kujton, në kufij paradigmaticë, se abrucezët janë ngrohur në shekuj me drutë e pyjeve të Dalmacisë...

Nga ana tjetër, përsa i përket Dalmacisë e në bazë të një sërë të dhënash dokumentare që kanë të bëjnë me historinë e asaj zone në epokën e mesjetës së ulët, asaj rilindase dhe moderne, Metzeltin¹⁴ na kujton se, një pjesë e

11 V. VALENTE, *Ibid.* fq. 261-262: lokaliteti i Kateluço dei Sauri (Castelluccio dei Sauri) (*Castellucium de Sclavis*, cituar në një akt të 1305), në rrethinat e Trojës Daunia (Pulja), dëshkohet si kolonia më e vjetër sllave në Itali. Kolonia tjetër sllave e Puljes është San Vito dei Normanni, që thirrej 'Shën Vito i sllavëve' ('San Vito degli Schiavi'), në provincën e Brindizit. Gjithashtu, duhet kujtuar se prania e sllavëve në Pulje dhe në Italinë Jugore shquhet nga një seri domethënëse toponimesh të bazuara në formën etnike *Schiavo/Schiavone* dhe në format që rrjedhin prej tyre, të hasura shpesh dhe në emra familjarë.

12 FARINELLI, *Lo spazio adriatico*, f. 20 në lidhje me situatën e veçantë të Mesdheut, përmend rastin emblematic të Aleksandrisë së Egjiptit kundrejt Kairos. Aleksandria, e pavarur dhe 'tjetër' përkundrejt Kairos, që gjithsesi është kryeqyteti i shtetit kombëtar. Dhe nënvizon faktin, sigurisht të dukshëm, që në të gjithë Mesdheun – ashtu si dhe në Adriatik – nuk ka pasur asnjë kryeqytet të shtetit të vendosur në bregdet. Algjeri dhe Tunizi janë kryeqytete vetëm prej shekullit XIX, ashtu siç është, në fakt dhe Athina. Para shekullit XIX kryeqytete të atyre që sot janë Algjeria dhe Tunizia gjendeshin në brendi të territorit përkatës dhe vetëm më vonë kur Algjeria dhe Tunizia u kolonizuan prej Francës, kryeqyteti u zhvendos drejt bregut, me kontakte më të mëdha dhe më të shpejta me itinerarët që të çonin në metropolet prej të cilave vareshin, që nuk ishin afrikane, por evropiane: Parisi. Për sa i përket Athinës, një tjetër kryeqytet mesdhetar, ajo u 'shpik' në 1834 për t'i dhënë dinjitet mbretërisë së Greqisë, të lindur nga luftrat për pavarësi kundër Portës së Lartë. Por metropoli përkatës për greqizimin ishte për një kohë të gjatë bashkësia greke e Kostandinopojës, zemër më se greke e Stambollit tashmë turk.

13 FARINELLI, *Lo spazio adriatico*, f. 21.

14 M. METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, në *L'italiano nelle regioni. Lingua nazionale e identità regionali*, a cura di F. BRUNI, Torino 1992, f. 320.

drithërave importojë aty rregullisht nga Puglia (Pulja); se në Raguzë bëhej kontrabandë kripe e ardhur nga kriporet puljeze; se Velja dhe krahina të tjera dalmate, nga ana tjetër, eksportonin drejt Puljes, Romës, Napolit dhe Markes (le Marche), sasi të mëdha kuajsh dhe mushkash¹⁵; se në qytete të ndryshme të Dalmacisë konti apo konsulli, kancelarët dhe noterët ishin zakonisht italianë (konsujt e Spalatos dhe Traut vinin zakonisht nga Ankona dhe Marke); se zakonisht në qytete mësuesit, mjekët dhe anëtarët e klerit të lartë ishin italianë dhe se, si përfundim, përparimi i turqve në Ballkan dhe qëndrimi armiqësor i tyre ndaj dalmatëve, bënë që këta të fundit të rrallonin raportet me vendet sllave dhe, nga ana tjetër, të fuqizonin raportet me Venecian, Firencen, Romën dhe Napolin. Në veçanti, Ragusa pati raporte të ngushta me Italinë fqinjë, sidomos me Puljan: tregtarët raguzanë mund t'i takojë në të gjitha qytetet e gadishullit: Venecia, Milano, Ankona, Ravena, Fan, Fermi, Gjenova, Bari, ashtu si dhe në Sicili, Sardenjë, Spanjë, Provencë dhe, madje anije raguzane bënëin vajtje-ardhje mes brigjeve dalmate dhe porteve të Fiandrave e të Anglisë¹⁶.

...Pikërisht në lidhje me shekullin XVIII, përfundimi i të cilit është në qendër të këtij Kuvendi, do të mjaftonte shfletimi i veprës së jashtëzakonshme *Regesti maritimi croati/Hrvatski pomorski regesti*, të N. Čolak, për të mbledhur në mënyrë të imët, në listat e anijeve dhe produkteve të transportuara prej tyre nga një port në tjetrin të të dy brigjeve të Adriatikut, rrjetin e dendur të trafikeve që, gjatë shekullit XVIII, krijoi një ind lidhës marrëdhëniesh mes njerëzve të dy brigjeve¹⁷.

15 VALENTE, *Fortuna dell'etnico*, f. 266-267 e kujton si sllav (*schivo*) termin që shënonte një lloj kali dalmat, me trup të vogël dhe atë të një race boshnjako-dalmate-shqiptare, importi i të cilit drejt Puljes dokumentohet gjerësisht duke u nisur nga shekulli XIV. Në dialektet e Puljes termi *škavë* emëronte 'kalë dalmacie' dhe, aty ku u humb kuptimi fillestar, do të thotë 'kalë i ri', apo 'mëz'. Në Molfetta është e gjallë shprehja *čučče dë la gëdërmäžë* 'gomar Dalmacie', referuar një njeriu, si sharje, sigurisht si kujtim i trafikeve mes dy brigjeve. Në Bitonto *čučče dë la dalmažjë* emërtonte një racë gomerësh të vegjël, të shpejtë dhe të hijshëm. Në Molfetta termi dokumentohet, për veti kalimtare, të emërtojë edhe *omënë* me shtat të vogël.

16 J. LUČIĆ, *Gli stranieri a Ragusa nel medioevo*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 345.

17 Citoj, meqë janë të thjeshtë, shembujt e zgjedhur mes 6891 të tillë, të regjistruara nga N. ČOLAK, *Regesti marittimi croati/Hrvatski pomorski regesti. Settecento. I Parte: Navigazione nell'Adriatico/I dio: Osamnaesto stoljeće. Plovidba na Jadranu. Vol. II, Fonti documentarie/Vrela Svez. II. I dokumentarna vrela*, Padova 1993, të mëposhtmit: «a. 1746, Ancona – Tartana 'Stella Tramontana' del reis Ibrahim Bilaçak, Dulcignotto, proveniente con carico di tabacco, pellami e cera»; «a. 1762, Ancona – Tartana di Ulcinj, reis Liko Bukuri, proveniente da Durrës con 50 b.le di lana, 600 b.le di tabacco e 80 pezzi bufalini cuoi»; «a. 1763, Ancona – Condrina di Kefalinnia del padrone Spiridion Rosolimos, proveniente da Trieste con carico di ferrarezze, seppie secche ed altre mercanzie di transito per Senigallia».

Bin¹⁸ kujton me të drejtë se «[...] megjithë vështirësitë, keqtrajtimet dhe abuzimet e shkaktuara nga ushtrimi i 'supremacisë së Gjirit', venedikasit ashtu si raguzanët, markixhanët ashtu si fumanët, puljezët ashtu si shqiptarët, kanë qenë gjithsesi në gjendje të përcaktojnë një *modus vivendi* me kohëzgjatje të madhe [...] të karakterizuar sidomos nga pragmatizmi dhe bon sens [...]».

Chaline përshkruan pastaj në mënyrë sintetike «le succès des rivaless» në një Adriatik të konsideruar si një realitet policentrik dhe, ndonëse shpall pamundësinë e kërkimeve në gjendjen e tanishme, për të dhënë një kuadër të plotë të tregtisë në Adriatik, në shekullin XVIII - «trop d'inconnues de taille demeurent. Il faudrait des études sur les négociants, sur les modalités de l'armement maritime, sur les assurances, les colonies étrangères, les échanges [...]»¹⁹ -, veçon gjithsesi protagonistët: veç Venecias, Habsburgut, porti i lirë (*Franco*) i Ankonës, portet adriatikase në mbretërinë e Napolit (Manfredonian, Barletan, Tranin), portin e Raguzës/Dubrovnikut.

1.3. Edhe më shumë: Adriatiku si pikëtakimi kulturor - madje dhe libror - mes botës së krishterë dhe asaj myslimane: në Fan, në fakt në 1514 u shtyp libri i parë arab, me botimin e psalmeve të kishës ortodokse malakite *Kitâb şalât as-sa'âti* (*Horologion, Il libro delle ore*), ndërsa në Venecia do të shtypet, disa vite më pas (1538) *Kurani* i parë, që më vonë u dogj, duket me urdhër të Paolo III, papa i Romës²⁰.

Vend shkëmbimesh dhe takimesh për marrëdhëniet e përditshme mes njerëzve të brigjeve përkundrejt, Adriatiku ka qenë gjithashtu ndër shekuj, edhe – nga antikiteti më i hershëm²¹, e sidomos nga mesjeta e

18 A. BIN, 'Mare clausum' e 'Mare liberum': la giurisdizione veneziana sul mare Adriatico e la decadenza di Venezia, in *Homo adriaticus. Identità culturale e autocoscienza attraverso i secoli*. Atti del Convegno internazionale di studio (Ancona, 9-12 novembre 1993), a cura di N. FALASCHINI et alii, Reggio Emilia 1998, f. 435.

19 CHALINE, *L'Adriatique, de la guerre de Candie*, f. 383.

20 D. TANASKOVIĆ, *Bacino adriatico: punto d'incontro librario islamico e cristiano*, in *Il libro nel bacino adriatico (secc. XV-XVIII)*, a cura di S. GRACIOTTI, Firenze 1992, f. 37-38.

21 P. CABANES, *Histoire de l'Adriatique*, thekson shumë herë se Adriatiku, 'le golfe profond', ka qenë gjithnjë rrugë penetrimi e botës mesdhetare drejt Evropës Qendrore: rruga e qelibarit në antikitet, vend tranziti mes Greqisë dhe Manja Greccia (Magna Grecia) (por dhe mes Greqisë dhe rrafshit Padan: themeluesi mitik i Padovës ishte greku Antenore, i kthyer nga Lufta e Trojës; Spina dhe Adria ishin zotërime greke në kontakt me botën etruske; koloni të tjera greke lindën në Dalmaci; Pharos, Stari Grad-i i sotëm, në ishullin Hvar; Issa, Vis-i i sotëm; Kerkyra Melaina, Korçula e sotme; Tragurion, Trogir i sotëm), dhe më pas kufi mes botës greke dhe asaj romane. Në qendër të pushtetit perandorak romak, që nga koha e Augustos, Adriatiku u bë në shekullin III kufi mes perëndimit dhe lindjes dhe pararojë kundër invazioneve barbare. Perandoria ishte në duar të perandorëve ilirë dhe Diokleziani e transformoi pallatin e Spalato-s në qendër të sundimit të tij. Pas 378 vizigotët dhe Alariku shkatërruan të gjithë bregun lindor të Adriatikut para se të merrnin Romën në 410. Rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit

vonë e këndej - vijë simbolike ndarëse që ka shënuar të gjithë historinë evropiane: vazhdimi i asaj vije thyrëse mes perëndimit dhe lindjes së Evropës, të asaj vije ndarëse – tipike ndërballkanike²² – mes dy segmentesh të kontinentit të vjetër, të orientuara simbolikisht njëra drejt Bizantit (dhe trashëgimtarëve të tij: Kostandinopoja dhe më pas Stambolli; por dhe drejt Kievit, Novgorodit e pastaj Moskës) dhe tjetra drejt Romës (dhe trashëgimtarëve të saj: kryeqytetet e mëdha të kulturës evropiane) në një dialog ku Venediku luajti rol të privilegjuar si ndërmjetësuese mes dy palëve të përfshira: dhe kjo gjendje e përshkon të gjithë historinë e pjesës lindore evropiane nga Bizanti deri tek otomanët.

Duke marrë shkas nga tri ‘qëndrueshmëri’ arkitektonike të hapësirës së Adriatikut, dhe për këtë, mjaft ‘të ndjeshme’ ndaj klimës së shkëmbimeve dhe ndërveprimeve që zona ka kryer mes perëndimit dhe lindjes, Farinelli²³ shtron, në mënyrë inteligjente, një pyetje interesante:

Shën Marku është një xhami apo një kishë katolike? Shën Nikolla i Barit është një kishë katolike apo një kishë ortodokse? Kullat e Pallatit Dukal (të

në 476, pa të vendosen në Ravenë dhe në dy brigjet e Adriatikut ostrogotët e Teodorikut, të zëvendësuar më pas në gjysmën e shekullit VI nga Justiniani (Giustiniano).

Duke u nisur nga gjysma e shekullit VI, invazionet e longobardëve në Itali dhe të sllavëve të Jugut në Ballkan, modifikuan thellësisht situatën e Adriatikut deri sa, arbitër mes planeve të Carlomagno-s dhe Konstandinopojës u bë Venediku, fuqi që po lindte në shekullin IX dhe, më pas, duke u nisur nga shekulli XI dominuese (mbizotëruese) absolute e hapësirës së Adriatikut i cili, nga ai çast u bë ‘liqen venedikas’ dhe ujërat e tij përfaqësonin vijën ndarëse mes Bizantit dhe ‘të tjerëve’: vijë ndarëse e theksuar pas 1054, për shkak të skizmës mes Romës dhe patriarkatit të Kostantinopojës dhe me vonë, akoma më e theksuar, pas 1204, për shkak të masakrës kryer në Kostandinopojë nga *φράγκοι* e Kryqëzatës së IV; më vonë vijë ndarëse mes katolicizmit roman dhe kristianizmit ortodoks dhe, në vazhdim, mes Perandorisë Osmane (që mos harrojmë – do të jetë e pranishme në Ballkan deri në 1912, në përfundim të Luftës së Parë Ballkanike) dhe krishtërit Perëndimor.

Në kohëra më të afërta për ne, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, Adriatiku u bë sërish kufiri i ndjeshëm mes Perëndimit dhe shteteve që iu nënshtruan, pas 1945, sferës së ndikimit sovjetik (megjithëse Jugosllavia e Titos, pas thyerjes me Stalinin në 1948, pati tendencën të ruajë një farë pavarësie përkundrejt Moskës).

Vdekja e Titos në 1980 shënoi fillimin e krizës së tmerrshme të federalizmit jugosllav dhe të konflikteve ndëretnike që pasuan në Kroaci, Bosnje, Kosovë. Në fillim të mijëvjeçarit të ri, Adriatiku është në qendër të reformimit të marrëdhënieve mes perëndimit dhe lindjes së Evropës. Dhe në lidhje me këtë, jap një të dhënë simptomatike: pas pesëdhjetë vitesh mbylljeje totale, bregdeti shqiptar në qytetin e Durrësit feks sot nga tabela reklamash që ftojnë për udhëtime drejt Barit, Ankonës, Venecias, Triestes...: gjë që nuk mendohej vetëm para pak vitesh.

22 Bëhet fjalë për vijën ndarëse mes zonës me influencë greko-bizantine dhe latino-ballkanike, të studiuar nga Kostantin Jireček në vitet e para të shekullit XX – shih C. JIREČEK, *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters*, Eien 1902 – dhe, në vitet më vonë nga Haralambie Mihăescu – cfr. H. MIHĂESCU, *La langue latine dans le Sud-Est de l'Europe*, București-Paris 1978.

23 FARINELLI, *Lo spazio adriatico. Via d'acqua e cerniera*, f. 18.

doxhëve) të Urbinit janë krejt kulla apo janë minare?

Tri ndërtesa domethënëse arkitektonike, simbole epokash të ndryshme në Adriatik, zbulojnë në fakt, nga një lexim i kujdesshëm i strukturave të tyre jo dhe aq të fshehura, elemente 'të shkrirjes' së tyre të paqartë me tipare të tjera, sipas një loje stilesh ku heterogjeniteti përftohet si një sintezë origjinale e admirueshme.

2. Objektiv i këtij kontributi është përshkrimi i funksioneve dhe i rolit të sistemeve të veçanta gjuhësore si faktor në fushë-lojën e Adriatikut në një fazë kohore të rëndësishme për ngjarjet historike të Evropës mbarë dhe, në veçanti, të gadishullit ballkanik dhe atij italian: apo kapërcyelli mes shekujve XVIII - XIX, fazë historike që njohu premisat e procesit të unifikimit të Italisë dhe të krijimit për herë të parë të shteteve kombëtare ballkanike e që, për pasojë, në rrafsh gjuhësor, njohu shtrimin nga ana e intelektualëve të arealeve të veçanta gjeo-linguistike, si në Itali ashtu dhe në Ballkan, të problemit të përvijimit të sistemeve gjuhësore të cilat, shenja të qarta të identitetit të patjetërsueshëm, do të vlenin si pika referimi për vetë ndërtimin e idesë së kombeve që po lindnin: bëhet fjalë për debatin pararomantik dhe romantik në Itali në lidhje me çështjen e gjuhës; bëhet fjalë për lëvizjet ballkanike, që u frymëzuan gjithsesi nga çështja e gjuhës italiane, që u përhap si në qarqet sllavo-jugore, ashtu dhe në ato neogreke dhe shqiptare.

Bëhet fjalë për një fazë historike në të cilën nuk hyn fjala 'nacionalizëm' në kuptimin që ajo ka, por më shumë për 'lindje të një ndërgjegjeje kombëtare', për 'formim të një orientimi kombëtar', diçka shumë e ngjashme me disa forma të 'patriotizmit', nëse i referohemi pohimit të Maitz, «[...] der nationale Gedanke eigentlich schon früher entstanden ist als die Nationen»²⁴.

2.1. Protagonist absolut i 'krizës' në zonën e Adriatikut në kapërcyellin mes shekujve XVIII - XIX është Venecia, pushteti i së cilës – i dobësuar tashmë nga humbja e Kretës (1669) dhe e kontrollit në det me zvogëlimin e pretendimeve të qytetit *marciano* ("Venecias që ka pajtor shën Markun") mbi Mesdheun lindor, dhe i kushtëzuar mjaft nga humbja e Moresë, pas paqes së Passaroëitz-it (1718) - mori goditjen përfundimtare nga pesha e traktatit të Campoformio-s (1797), ngjarje epokale që shënoi, me kthimin e territoreve nga *Serenissima* ('Fort e Kthjella Republikë') Napoleonit të Austrisë²⁵, përfundimin e pushtetit të *doxhit*, jo vetëm mbi zotërimet në

24 P. MAITZ, *Sozialpsychologie des Sprachverhaltens. Der deutsch-ungarische Sprachkonflikt in der Habsburgermonarchie*, Tübingen 2005, f. 78 shën. 32.

25 Mbi pasojat e traktatit të Campoformio-s në lidhje me raportet e reja të forcave të vendosura midis Francës napoleonike dhe Perandorisë Osmane, me rënien e

Adriatik dhe Jon, por dhe më gjerë, kudo në toka ku ishte shpalosur flamuri *marciano*. Shkaku: neutraliteti i Republikës ndaj qëllimeve për zgjerime kufijsh nga ana e Francës dhe Austrisë dhe, sipas Chaline²⁶, edhe «[...] la lassitude du patriciat» aq sa, *Ibid. f. 400*:

Viti 1797 është rezultat, më shumë pa ndonjë rëndësi të veçantë sesa tragjik, i një dobësimi të ngadaltë e të parikuperueshëm të fisnikërisë venedikase, demografikisht në rrënim e sipër. «Epopëja e vdekjes» (për të risjellë formulën e Gérard Delille) që është historia e patricëve qysh prej shekullit XVI, merr fund me parapëlqimin e detyruar të zhbërjes së kësaj shtrese si elitë drejtuese, për të mbijetuar në kushte pak a shumë të mira, si fisnikëri provinciale.

Venediku, në fakt, gati shtatëdhjetë vjet para atij *vulnus* (dëmi) që e theu në Capofornio, kishte parë t'i kufizohej roli tradicional (dhe shekullor) si treg furnizues i Adriatikut, në favor të Triestes dhe Fiume/Rijekës. Në lidhje me këtë duhet kujtuar një kufi kohor i rëndësishëm: viti 1719, kur vetëm një vit pas paqes së Passarowitz-it, Habsburgu i kishte transformuar Triesten dhe Fiume/Rijekën, portet e tyre të 'lira' ('porti franchi'), në tregjet e Perandorisë dhe në veçanti kishin pajisur Triesten me një kantier detar që u konvertua në 1723 në arsenal ushtarak ku u ndëruan²⁷ disa njësi për beteja detare, një anije luftarake dhe mjaft mjete lundruese me rrema. Nuk është i çuditshëm, me sa duket, fakti që ekuipazhet e ngarkesave të tilla vinin nga brigjet e Istrias dhe Dalmacisë, ndërsa është interesante të kujtohet që oficerët ishin rekrutuar nga fuqi të ndryshme evropiane, tashmë me përvojë në teknikat moderne të lundrimit²⁸.

Në 1776, Maria Teresa, për t'i dhënë një dalje të re në det Kroacisë dhe Hungarisë, nëpërmjet bashkimit të kësaj të fundit me Kroacinë, e shkëputi qytetin Fiume/ Rijeka nga Austria dhe i dha qytetit istrian statusin e *corpus separatum*, gjysmë autonome nga kurora hungareze. Me lindjen e industrializimit të parë dhe falë frymës ndërmarrëse që rrezatonin strukturat parakapitaliste, në vitet midis 1823 dhe 1848 u themelua në Fiume/Rijekë një kantier ku u ndërtuan anije që kërkoheshin nga e gjithë bota. Ky aktivitet i solli fitime të mëdha qytetit: Fiume/Rijeka quhej – siç e

Republikës së Venedikut, bën gjerësisht me dije G. CASTELLAN, *Histoire des Balkans. XIV -XX^e siècle*, Paris 1991, fq. 225-229. Në zonën e Ballkanit u formuan ekuilibra të rinj, me ndërhyrjen dhe të Rusisë cariste, aleate me Stambollin kundër superfuqisë franceze. Ishujt Jonikë, pasi kaluan në 1800 një kohë të shkurtër nën kontrollin ruso-otoman, formuan një republikë të pavarur (për në fakt nën protektoratin e Rusisë) që zgjodhi në krye të qeverisë një fisnik nga Korfuzi, Ioannis Kapodistrias (1776-1831).

26 CHALINE, *L'Adriatique, de la guerre de Candie*, f. 400.

27 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 327.

28 Në krye të flotës së parë habsburgase, të cilës iu bashkangjitën anije të linjës napoletane ('San Carlo Borromeo', 'Santa Elisabetta' dhe 'San Michele') u vu në 1725, nënadmiralet Deigham, me origjinë angleze.

kujton Santarcangeli (1971-1973: 481)²⁹ – «la più bella perla della corona ungarica» (perla më e bukur e kurorës hungareze) dhe valëvitej nëpër Hungari motoja «Tengerre, magyar!/ Magiari, sul mare!» (Magjarët në det!). Në flamurin e marinës luftarake austro-hungareze, që demonstronte në Trieste, Pola/Pula, Fiume/Rijeka forcën me vepra të mëdha (porte, shkolla, kazerma, ofiçina), u shfaq krah ngjyrave të Austrisë edhe tringjyrëshi hungarez.

Në 1801, Duka i Madh Carlo kishte themeluar në Venecia një shkollë kadetësh dhe inxhenerësh lundrues, kishte marrë komandon e Arsenalit duke i dhënë formë të re trupës *fanti del mar* ("trupa speciale zbarkimi nga deti"); në 1814 Armata Lundruese Perandorake u nda pastaj në tri departamente (Venecia, seli e komandës, Trieste dhe Zara/Iadar), por pas vitit 1849, Trieste dhe Pola/Pula parapëlqehen në krahasim me Venecian dhe komanda e kolegji detar, u zhvendosën në Trieste. Mbishkrimi zyrtar *Österreichisch- venezianische Marine* u zëvendësua me *K. und K. Kriegsmarine* dhe komandantë, nga ai moment qenë vetë austriakët, siç shënon shprehimisht N. Agostinetti³⁰.

2.2. Kriza e Venedikut dhe forcimi i pushtetit habsburgas në Adriatik, shkonin njësh me krizën e botës turko-otomane, asaj bote që falë territoreve ballkanike nën kontroll të saj (sanxhakët e Bosnjës, Malit të Zi, Serbisë, Shqipërisë, Epirit, Moresë: me fjalë të tjera territoreve të Rumelisë), kishte pasur për shekuj me radhë një rol domethënës në hapësirat e Adriatikut dhe të Jonit³¹: në kapërcyellin mes shekujve XVIII - XIX, dobësimi i pushtetit të Portës së Lartë ndihmoi lindjen e lëvizjeve të para për pavarësi në hapësirë ballkanike, të cilat në dhjetëvjeçarët në vazhdim do të çojnë në krijimin e mbretërisë së Greqisë, të principatave rumune e të shteteve kombëtare sllavo-jugore (mbretëria e Greqisë, mes 1821 dhe 1832-shit; principatat rumune, në 1822; principata e Serbisë, në 1830; më vonë, në 1848, do të jenë revolucionet e Moldavisë dhe të Vllahisë; në 1852 u themelua principata e Malit të Zi; me Traktatin e Berlinit, në 1878, u bënë të pavarura Rumania, Serbia, Bullgaria). Paralelisht, në fushë-lojën veriore të Adriatikut dhe konkretisht, për formimin e identitetit kombëtar të dy anëtarëve të tjerë të rëndësishëm sllavo-jugorë (kroatëve dhe sllovenëve), duhet kujtuar dialektika mes Vjenës dhe Budapestit për të përcaktuar fatet e ardhshme të Kroacisë dhe Sllovenisë dhe për pasojë rolin që luajtën, në një kontekst të tillë, dy gjuhë të rëndësishme të Evropës Qendrore -

29 P. SANTARCANGELI, *Una terminologia marinaresca ungherese*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 481.

30 N. AGOSTINETTI, *L'Imperial Regia Marina Veneta*, «Rivista Dalmatica», 58 (1987), f. 177-187.

31 Y. TERNON, *Empire ottoman. Le déclin, la chute, l'effacement*, Paris 2005, f. 88-96.

gjermanishtja dhe hungarishtja – ndërvepruese në përmasa të ndryshme me kuadrin gjuhësor qendror dhe verior të Adriatikut.

2.3. Panorama gjuhësore e zonës së Adriatikut, në kapërcyellin mes shekujve XVIII - XIX, karakterizohej nga një seri e pasur sistemesh gjuhësore vepruese në masë të ndryshme në nënzonat e veçanta të territorit: sistemet romane (italo dhe ballkano-romane), sistemet sllavo-jugore, sistemet shqiptare; në kufijtë jugorë të Adriatikut, në fillim të zonës së Jonit, sistemet neogreke. Për secilën nga këto përbërëse do të flas më poshtë, duke iu referuar në veçanti peshës dhe rolit të tyre në ambientin e Adriatikut në kapërcyell mes dy shekujve.

Gjithsesi, në formën e një ideje-bosht për të ndihmuar leximin, duhet thënë se në zonat e Adriatikut, ku gjendeshin këto sisteme, ishin të pranishme realitete diglosie e/apo dygjuhësie: realitete të ndryshme, me gjasë, sipas situatave dhe natyrisht, sipas kushteve sociolinguistike aspak ‘të qëndrueshme’; të tilla gjithsesi që paralajmërojnë dialektika pak a shumë të forta mes përdorimeve gjuhësore të përditshme, të lidhura me gjuhën e folur dhe përdorimeve gjuhësore me funksione ‘të larta’, të përfaqësuara nga ato që për të përdorur një terminologji klosiane³², mund të konsiderohen me të vërtetë nivele ‘tavan të gjuhës’.

Për sa i përket ‘gjuhëve tavan’, teatri i përdorimeve gjuhësore të segmenteve të veçanta të zonës së Adriatikut, ndërlikohet më pas – nëse duam ta konsiderojmë ‘mënjatë’ funksionin e latinishtes, mjet formimi i privilegjuar për elitat e kohës në të gjithë Evropën e kulturuar³³ - për shkak të pranisë së italishtes letrare (që influençoi të gjithë ambientin e Adriatikut Perëndimor dhe Lindor³⁴), dhe të sllavishtes kishtare, thënë

32 H. KLOSS, *Grundfragen der Ethnopolitik im 20. Jahrhundert. Die Sprachgemeinschaften zwischen Recht und Geälit*, Eien-Stuttgart 1969.

33 Për peshën e latinishtes në arsimimin e ‘klasave fisnike dhe në gjendje të mirë’ të Republikës së Vendikut dhe të dialektikës së saj me italishten informojnë M. CORTELAZZO - I. PACCAGNELLA, *Il Veneto*, në *L’italiano nelle regioni. Lingua nazionale e identità regionali*, a cura di F. BRUNI, Torino 1992, f. 255-256, me të dhëna interesante për sa i përket përdorimit të latinishtes në didaktikën e Universitetit të Padovës ku «tradita parashikonte, edhe në leksionet e profesorëve, bashkimin e latinishtes - me mësimin përmendësh; profesori i recitonte mësimet e tij përmendësh, pa ndihmën e shënimeve dhe në latinisht.

Jehona e saktë e një klime të tillë që përfshinte edhe ambientet e kultivuara të botës kroate, slovene dhe serbe, gjendet në mënyrë paradigmatiche, siç thekson F. BRUNI, *Introduzione*, në N. TOMMASEO, *Scintille*, a cura di F. BRUNI, Parma, 2008, f. XXI, në formimin e Niccolò Tommaseo-s: «[...] formim latin i ndërtuar nga mësimdhënia, mëgjithëse e mërzitshme e xhaxhait, françeskanit Antonio Tommaseo dhe e mësuesve të seminarit të Spalato-s [...]».

34 Emërtimi i referohet rolit të italishtes letrare në dinamikat e brendshme të ‘italishteve rajonale’ të ndryshme që po formoheshin në zonat gjeo-gjuhësore të vendosura përgjatë bregut italian të Adriatikut: nga Venediku në Romagna, në Marche, Abruzzo,

ndryshe edhe 'sllavishtja e përbashkët' (me të cilën do të ndërveprojnë gjuhët sllavo-jugore), të turqishtes osmanishte (që ndikoi ambientet boshnjake, malazeze, shqiptare), të greqishtes së re (që ndikoi ambientin shqiptar dhe një pjesë të ambientit sllavo-jugor) dhe më së fundi, të gjermanishtes (që ndikoi ambientet e kroatishes dhe sllovenishtes) dhe të hungarishtes (që ndikoi ambientin kroat).

Më poshtë, për secilin nga 'aktorët' gjuhësorë veprues në skenën e Adriatikut, do të sjell të dhëna dhe konsiderata të cilat, pa qëllimin që të jenë shteruese, duan të tërheqin vëmendjen, nga njëra anë, për disa arritje 'të padiskutueshme' të realizuara nga kërkimi dhe në tjetrën të parashtrojnë disa rrugë të reja, të denja sipas meje, për pak vëmendje.

3. Për sa i përket dinamikave romane vepruese në zonën e Adriatikut, duhet thënë para së gjithash, që ato ishin (dhe pa dyshim, janë ende) qartësisht të ravigjzuara nga kufiri gjuhësor ndërroman që ndan, në mënyrë të prerë, Rumaninë Perëndimore nga Rumania Lindore: zonat e Adriatikut Verior, që ndodhen përmbi (mes të tjerash, e copëzuar) vijën 'la Spezia-Rimini', i përkasin, siç dihet, pjesës perëndimore të Rumanisë, me të cilën ndan tiparet kryesore të rrafshit fonologjik dhe morfo-sintaksor; nga ana tjetër, zonat e Adriatikut ballkanik Qendror dhe Verior dhe e gjithë Rumania ballkanike përbëjnë fragmente të ndryshme të Rumanisë Lindore: dalmatishtja e vjetër dhe dialektet rumune (si ato danubiane ashtu dhe ato nëndanubiane), përveç elementeve 'të drejtpërdrejta' romane që vazhdojnë në shqipe, në greqishte të re dhe në gjuhët sllavo-jugore, shfaqin raporte të pastra dhe të padiskutueshme me realitetin e folësve italo-romanë jugorë dhe, në një farë mase (më të vogël), të folësve italo-romanë qendrorë.

Jo për shkak raportesh 'të drejtpërdrejta', përkundrazi fryt i një kolonizimi' vërtet kulturor dhe gjuhësor e që përfshiu, për disa shekuj, të gjithë bregdetin lindor të Adriatikut, pati si përgjegjëse të parë dhe absolute, natyrisht Venedikun³⁵. Kështu që, pikërisht para njëzet vjetësh,

në Puglie. Pikë referimi e detyrueshme për këtë janë studimet themelore për zonat e veçanta të përmendura që gjenden në F. BRUNI, a cura di, *L'italiano nelle regioni: lingua nazionale e identità regionali*, Torino 1992.

- 35 Madje, mund të thuhet se pjesa më e madhe e elementeve të nënkuptuar në përgjithësi si 'italiane', të dokumentuara në shqipe dhe në greqishte të re (dhe nga këto gjuhë të migruara pastaj, me sa duket, brenda gjuhëve të tjera ballkanike) janë kryesisht 'veneciane', siç dëshmon në mënyrë të pakundërshtueshme veshja e tyre fonomorfologjike. P.sh. emrat e tipit shqip *monedhë* nga gr.e re *μικράδα* (*sole cocente* "diell që djeg") (< *ἡλιακός* + *-άδα*), të dyja me rezultatin në spirante të prapashtesës veneciane *-ada* (< lat. volg. *-ata*); apo të leksikut të lartë të tipit *lexoj* < ven. *lezer*, siç shënohet qartë në G.B. PELLEGRINI, *Avviamento alla lingua albanese*, Rende 1998 e da F. VICARIO, *Elementi veneti in albanese*, in *Guida ai dialetti veneti*, XII, a cura di M. CORTELAZZO, Padova 1990, f. 33-45.

Claudio Magris³⁶, sillte në kujtesë – në gazetën *Corriere della Sera* të njëzet shkurtit 1990 – një imazh të një vizionari të madh të Adriatikut, poetit Biagio Marin:

Nësë Fryma e Botës do të vendosë të fshijë praninë istriano-venedikase nga Adriatiku, unë do të ul kryet dhe do të them ‘fiat voluntas tua’, por pastaj nga vetja do të shtoj “ndyrësirë...” dhe këtu hidhte një sharje të mirë, tradicionale (klasike) që edhe laicizmi më i shpenguar i kohëve moderne, apo i betejave antiklerikale nuk do mund të lejonin të jepej në ‘Corriere della Sera’.

3.1. Venediku, falë pushtetit të administratës dhe trafikeve tregtare dhe kulturore të *Serenissima*-s, rrezatoi për shekuj (duke u nisur nga dy shekujt e fundit të mesjetës së hershme e deri gjatë gjithë shekullit XVIII) përgjatë gjithë bregut lindor³⁷ dhe në një pjesë të mirë të atij perëndimor të Adriatikut³⁸ një sërë varietetesh gjuhësore të ndryshme – në diastrati, diafazi, diamezi – të cilat, sipas mendimit tim, duke mbajtur parasysh përshkrimin sociolinguistik të zonës së Venedikut, parashtuar në punët e përmbledhura të kryera me shumë saktësi nga A. Zamboni, mund të klasifikohen në këtë mënyrë³⁹:

i) Dialekti venecian i ulët nga pikëpamja sociolinguistike, apo mjete gjuhësor i përditshëm, i përdorur nga shtresat e ulëta të popullsisë, i konotuar nga tipare të dallueshme popullore: një varietet i tillë, i ndërmjetësuar sidomos nga ambienti detar, është provuar gjerësisht, përveçse gjatë gjithë bregut dalmat, edhe përgjatë brigjeve italiane.

Në lidhje me këtë, në Rimini, na informon Cortelazzo⁴⁰ – peshkatarët përdornin një dialekt të ndryshëm nga ai romanjol (*romagnolo*) i ashtuquajtur ‘portolotto’ (d.m.th. dialekti i portit), përshkruar nga Bellosi⁴¹ dhe akoma i gjallë në fillim të shekullit XX. Ishte një idiomë e tipit venecian, e ndryshme nga ajo e qytetit dhe rrethinave të tij, “një fakt ky shumë interesant se marinarët e Riminit kuptoheshin më mirë me ata të ishullit

36 C. MAGRIS, *L'infinito viaggiare*, Milano 2009, f. 125.

37 F. URSINI, *L'identità veneto-dalmata tra le diverse correnti di lingua e di cultura dell'area adriatica orientale*, në *Homo adriaticus*, a cura di N. FALASCHINI et alii, 1998, f. 84-85.

38 M. TRUMMER, *Südosteuropäische Sprachen und Romanisch/Langues sud-est européennes et langues romanes*, në «Lexikon der Romanistischen Linguistik», VII (1998), f. 149-153.

39 A. ZAMBONI, *Veneto*, Pisa 1974; A. ZAMBONI, *Italienisch: Areallinguistik IV / Aree linguistiche IV – a) Venezien / Veneto*, «Lexikon der Romanistischen Linguistik», IV (1988), f. 517-538.

40 M. CORTELAZZO (a cura di), *Guida ai dialetti veneti*, XV, Padova 1993, f. 76-77.

41 G. BELLOSI, *Il portolotto: la parlata del porto di Rimini*, në *Guida ai dialetti veneti*, XV, a cura di M. CORTELAZZO, Padova 1993, f. 205-209.

të Veljës që ishte larg sa të hante syri, sesa me fshatarët dy kilometra larg prej tyre”. Dhe një peshkatar i vjetër nga Rimini, gjatë lëvizjeve të 1831-shit, i drejtohej kështu autoriteteve: «Sior cavalier, ghe demandémo una grassia: non volémo più pagar el pàvolo che paga i barchéti ogni sitimana quando i va a pescar». Dhe mënyra e këndshme me të cilën marinarët e Riminit i drejtohen vajzave («Ciò, so mi che passe») të sjell në mendje më shumë Chioggia-n se sa Venecian. Në Ankona fëmijët ishin quajtur (dhe janë ende, pjesërisht) *mamuli*, *mamulini*, zë i lashtë venedikas; ashtu si në Jesi, fëmijët quhen *mammoli*, *mammolétti* dhe, poshtë fare duke zbritur brigjeve të Adriatikut Perëndimor, kujtimi i *Serenissima*-s jeton në kontekste të tjera, nëse mund të pohojmë që në një zonë të gjerë nga Abruco në Pulia ‘*portamonete*’ (mbajtësja e monedhave) quhet në të folmen veneciane *portazecchini* – dhe – siç bën të ditur Valente⁴² – formula tipike e përshëndetjes veneciane *sçáo* > it. *ciao* (që vetë rrjedh nga lat. *sclavus*) dëgjohej dhe dëgjohej ende në fonetizmin venecian në Bitonto (*fa u skjávë* - “hap dhe mbyll gishtat e dorës për të thënë tungjatjeta”), në Salento (*jeu li dissì schiáu* “unë i thashë tungjatjeta”, formulë e dokumentuar në një poemë në dialektin salentin, e shkruar rreth 1700-ës dhe në dialektet abruceze dhe napolitane (*fa škavë* “përshëndet me dorë, tipike e fëmijëve”).

Në fshatrat e ishullit Korfuz, më shumë se dy shekuj pas braktisjes së ishullit nga ana e venedikasve, jehona e dialektit të Venecias është ende e fortë dhe e ndjeshme. Galeazzo⁴³ ka takuar aty terma të jetës së përditshme veneciane: *despeto*, *campielo*, *canaletto*, *cargo*, etj., ashtu si *rîva*, *rîzi-bîzi*, *rizôt*, *rôba*, *rôba da mati*, *rôda*, etj., janë regjistruar në një leksik të kohëve të fundit të serbishtes malazeze⁴⁴. Më tej, materiale interesante janë sjellë

42 VALENTE, *Fortuna dell’etnico*, f. 267-268.

43 P. GALEAZZO, *Voci italiane e veneziane nel dialetto di Corfù*, «Lingua nostra», 48 (1987), f. 84-89.

44 M. CORTELAZZO, *I prestiti lessicali adriatici*, në *Homo adriaticus*, a cura di N. FALASCHINI et altri., Reggio Emilia 1998, f. 79. Më të rralla ndikimet e kundërta: në dialektet abruceze *cignottë*, *duggenòttë* < ‘ulqinjot, banor i Ulqinit’ ka vlerë fyese, ashtu si dhe *raguseo* < ‘banor i Raguzës’ emërton në Adriatik ‘dorështrënguar, fajdexhi’. Për këto e të tjera zëra shih Ž. MULJAČJĆ, *Elementi slavi nei dialetti italiani*, in *Elementi stranieri nei dialetti italiani*, I, Pisa, 1986, f. 127-152 ndërsa mbi zgjatimet dialektore të *schia-v-s* ‘sllavishtes’ etnike na jep të dhëna V. VALENTE, *Fortuna dell’etnico*, duke iu referuar, në veçanti (*Ibid.*, pp. 270-271) përparimit semantik të *schia-vone-s*, e përdorur shpesh (në Bisceglie) si *škaváunë* në kuptimin ‘xhuxhmaxhuxh, gjeni i së keqes’; në Trani *škavonë* do të thotë një ‘qënie e frikshme, keqbërës, rrëmbyes vajzash’, gjurmë e famës së keqe të së ashtuquajturve Schiavoni si tregtarë dhe, ndonjëherë, si piratë, autorë rrëmbimesh dhe vjedhjesh, aktivitete që shpesh shkonin bashkë. Sulmet e piratëve dalmatë në brigjet e Puljas ndihmuan të krijohesh dhe të ushqehesh në ndenjat popullore një famë legjendare e tipareve të frikshme të sllavëve (*Schiavoni*). Diçka e ngjashme u vërtetua, për të njëjtat motive, edhe për sulmet saraqene derisa ende sot, në Pulja, “me ëndërru turqit” (*sognare i Turchi*) do të thotë ‘të kesh makthe, të shohësh ëndrrat më të këqija’. Me një fjalë: ‘nënë, turqit!’ (‘mamma li Turchi!’)

nga Ikonomou⁴⁵.

ii) Dialekti venecian i mesëm dhe i lartë nga pikëpamja sociolinguistike, apo gjuha që nga këndvështrimi diafazik është më 'e kontrolluar', tipike e klasave të mesme dhe të larta të *Serenissima*-s. Ai venecian që shërbente dhe në marrëdhëniet diplomatike ndërkombëtare, sipas rekomandimit të doxhit të Venedikut, gjyqtarëve të dërguar në Turqi: «Se ti vedi el Gran Turco parlighe in venezian» bartur nga Dudan⁴⁶; që përdorej normalisht edhe në ndërhyrjet e senatorëve në Këshillin e Lartë (*Maggior Consiglio*).

Cortelazzo⁴⁷ (1982: 71) përmend – në bazë të dëshmisë së Francesco Zorzi Muazzo – që «[...] ende në kulm të shekullit XVIII nuk lejohej, përndryshe bëheshe objekt talljeje, të shqiptoje fjalë 'toskane', d.m.th. të huaja, siç rrëfen këndshëm Francesco Zorzi Muazzo në lidhje me të ashtuquajturën '*toscaneggiare*'⁴⁸ (e folur me tiparet e të folurës së Toskanës) të kancelarit Grando Colombo...» - po e marr citimin nga Zolli⁴⁹ -, i cili kancelar Grando, [...] duke pasë nxënë pak shqiptim të toskanës, aq sa dukej sikur tonin e kish harruar dhe duke pasë patur nevojë të përmendë në Këshillin e Lartë disa emra zotërinjsh të zgjedhur në detyra të larta, që ne zakonisht quajmë *stridare*, shqiptoi nuk di se cilin emër pak të fryrë, gjë që e çoi të gjithë Këshillin e Lartë të qeshte [...].

Dhe siç del në pah, sërish, nga një shkëmbim batutash mes dy personazhesh të komedisë goldoniane *Una delle ultime sere di carnovale* (VIII, 24) ku Sior Anzoletto, që braktis botën e tij të vogël dhe *lenuazo*-n e tij

45 TZ. IKONOMOU, *Le isole Ionie, la Grecia e il Supplizio*, në N. TOMMASEO, *Il supplizio di un italiano in Corfù*, Venezia 2008, f. 322-323.

46 B. DUDAN, *Il dominio veneziano di Levante*, Bologna 1938, f. 268, shën. 2.

47 M. CORTELAZZO, *Il veneziano, lingua ufficiale della Repubblica*, në *Guida ai dialetti veneti*, IV, a cura di M. CORTELAZZO, Padova 1982, f. 71.

48 Për procesin e italianizimit të venecianishtes (apo 'toskanizimin' e saj), proces veprues qysh në shekullin XVI, dëshmon shumë mirë – pohon M. CORTELAZZO, *Ibid.*, f. 71 – mënyra e të shkruarit të «diplomatit të ri dhe të kulturuar poliglot [...] Federico Badoer [proza e të cilit] duhet shënuar ndër prozat më elegante të shekullit XVI»; dhe, më tepër se kaq, është dëshmitar figura e ndritur e Pietro Bembo-s, mbështetës i bindur i shkëlqimit të toskanishtes përmbi të gjitha të folurat e tjera të Italisë – përfshirë edhe venecianishtja – pasi i dukeshin, në rrafsh fonologjik ato toskane (cituar me lart *favelle* – "fjalët") të kishin tingull më të mirë, që ato veneciane nuk e kanë, më të ëmbël, më të hepushëm, më të shpejtë, më të gjallë», në rrafsh morfo-sintaksor «[...] bëjnë më kujdes për rregullat, për kohën, për numrin, nyjet, vetat» dhe së fundi, për sasinë e pasur të personaliteteve letrare që në Venecia mungojnë: «Varfëria dhe mungesa e shkrimtarëve, mendoj të ketë ndodhur, prandaj, dhe në të shkruar gjuha nuk i kënaq pritshmëritë, them në letër, ashtu siç është ajo në gjuhën e popullit kur arsyetohet dhe flet dhe nuk mund të merret nga shkrimet, pasi ne, shkrimtarë të denjë dhe të pranuar, ashtu siç thashë, nuk kemi».

49 P. ZOLLI, *La 'Raccolta de' proverbii, detti, sentenze, parole e frasi veneziane' di F. Z. Muazzo*, «Studi Veneziani», 11 (1969), f. 575-576.

të ëmbël, rrëshqet në italianizma apo fjalë aulike, aty për aty të përqeshura nga Siora Marta, veneciane me rrënjë:

Sior Anzoletto: “Ma xe vero, altresí”

Siora Marta: “Bello quel altresí; el scomenza a parlar forestier”

Atëherë, Sior Anzoletto hesht dhe e mbyll

Sior Anzoletto: “Tutto quello che la comanda. Parlerò venezian...”

iii) Venecianishtja koloniale – ‘*veneziano de là da mar*’ (‘venecianishtja përtej detit’) – shprehje e përdorimeve të gjuhës së përvojës detare dhe tregtare në zonat e Levantes që i janë nënshtruar kontrollit të *Serenissima*-s.

Veç këtyre varieteteve kryesore, me vështirësi të dallueshme nga njëra-tjetra për shkak të ndërveprimit të përhershëm, sidomos, mes venecianishtes ‘së mesme dhe të lartë’ dhe venecianishtes koloniale, Venecia ka qenë ndërmjetëse e fuqishme për përhapjen në të gjithë zonën e Adriatikut Lindor (dhe jo vetëm aty, duke e shtuar influencën e saj dhe në ato territore të Greqisë ku qe e fortë prania e saj: pra në Egje dhe në Mesdheun Lindor):

iv) të latinishtes së periudhës së vonë të humanizmit, sidomos si gjuhë kulture pranë *elitave* të Dalmacisë (sllave dhe venedikase) dhe, nga ana tjetër e elitave habsburgase dhe hungareze;

v) të italishtes letrare, të ndërmjetësuar nëpërmjet prestigjit të modeleve të mëdha të letërsisë së redaktuar në toscanisht dhe të forcuar, edhe falë përdorimit;

vi) të italishtes së kishës katolike të përhapur në ambientet e katolicizmit roman të kundërreformës për të siguruar ndjekës të rinj (*proselitismo*), sipas rregullave të Konkilit të Trentit, drejtuar ndaj ballkanasve (dhe më gjerë, ambientit grek e gjeo-mesdhetar) që bënë pjesë në sferën e ndikimit të ortodoksisë dhe islamizmit;

vii) të italishtes burokratiko-administrative, gjuhë e privilegjuar e ndërveprimeve mes burokracive evropiane dhe Portës së Lartë dhe më gjerësisht, gjuha e diplomacisë ndërkombëtare;

viii) e italishtes bisedimore, gjuhë e kontakteve jo vetëm ndëradiatikase, por më gjerë ndërmesdhetare, e lidhur veçanërisht me gjithë Lindjen: ajo lëndë gjuhësore që Foscolo – i cituar nga Bruni⁵⁰ – do ta quajë ‘gjuhë itinerante’ apo ‘tregtare’.

Kuptohet që pjesë të niveleve gjuhësore të cituara gjenden, në një masë të mirë, edhe në formën e përbërësve të një realiteti tjetër gjuhësor, të rëndësishëm në historinë gjuhësore të të gjithë Mesdheut (dhe për pasojë

50 F. BRUNI, *Per la vitalità dell'italiano fuori d'Italia. I. Notizie sull'italiano della diplomazia internazionale*, «Lingua e Stile» 62 (2007), f. 201.

shtrihet dhe në Adriatik): apo në gjuhën polimorfe ‘*franca*’ (‘të lirë’), sistem i thjeshtëzuar nga pikëpamja morfologjike dhe sintaksore, e dokumentuar herët dhe fryt i përzierjes së shumë sistemeve gjuhësore mesdhetare: romane, romeike (greqishtes së re), arabe, turke, berbere⁵¹, sistem ky ‘fatlum’ pasi, siç vëren me të drejtë Dakhlija⁵²:

Lingua franca nuk sheshon [...] asnjë diferencë midis folësve, që termi vetë i shënon si të huaj ndaj njeri-tjetrit. Ajo i shërbeu, në fund të fundit alteritetit, dhe këtë e bëri edhe kur provonte, në të kundërt, të sillej vazhdimisht [...] si gjuhë e përbashkët. Ishte pra gjuha e një gjysmë rrugëtimi reciprok drejt njëri-tjetrit, hapësirë e ndërmjetme ku vihej në lojë mjaft mire, njëkohësisht edhe roli i frenuesit, në ruajtjen e diferencës dhe në identifikimin e hapësirave që dallojnë mes tyre [...] Mund të thuhet, me këtë rast, gjuhë *du milieu du gué* (“objekt i dy shënjestrave”).

Për sa i përket, më specifikisht, repertorit gjuhësor të Venecias së shekullit XVIII, Cortelazzo - Paccagnella⁵³ përvijojnë tiparet themelore, duke e paraqitur si të orientuar drejt tri skajeve të ndryshme: italishtes, venecianishtes dhe frëngjishtes. Pasqyrë mëse domethënëse e një situatë të tillë, është jo vetëm trigjuhësia e Goldonit⁵⁴, por dhe fakti se, ende në shekullin XVIII përktheheshin në venecianisht vepra poetike të shkruara në

51 Për karakterin e ndërlikuar të shtresëzimeve gjuhësore cilësi e ‘*lingua franca*’ (‘gjuhës së lirë’), shih H. KAHANE - HANEAHANE - A. TIETZE, *The Lingua Franca in the Levant. Turkish Nautical Terms of Italian and Greek Origin*, Urbana 1958; J. CREMONA, ‘*Accioché ognuno le possa intendere*’ *The use of Italian as a lingua franca on the Barbary Coast of the seventeenth century. Evidence from the English*, «Journal of Anglo-Italian Studies», 5 (1997), f. 2-69; G. CIFOLETTI, *La lingua franca barbaresca*, Roma 2004; J. DAKHLIA, *Lingua franca. Histoire d'une langue métisse en Méditerranée*, Paris 2008; F. VENIER, *Cent'anni dopo. Nota al testo di Schuchardt e note bibliografiche*, «Linguistica e Filologia», 29 (2009), f. 33-60; H. SCHUCHARDT, *La lingua franca*. Trad. it F. VENIER, «Linguistica e Filologia», 29 (2009), f. 7-31.

52 DAKHLIA, *Lingua franca*, f. 473.

53 M. CORTELAZZO - I. PACCAGNELLA, *Il Veneto*, in *L'italiano nelle regioni. Lingua nazionale e identità regionali*, a cura di F. BRUNI, Torino 1992, f. 253.

54 Argument për të cilin ka shkruar faqe të ndritshme, mjaft të rëndësishme *L'italiano in Europa. Esperienze linguistiche del Settecento*, Torino 1983, f. 89-113, me shënimin se (*Ibid.*, f. 93) «[...] termi ‘dialekt’ në kuptimin e zakonshëm është i papërshtatshëm për të shprehur përvojën gjuhësorë venedikase të Goldonit. [...] Goldoni është krejt jashtë raportit mes gjuhës letrare dhe dialektit. Dialekti nuk mbetet të jetë gjë tjetër për të, përveçse term deformues përqsasjeje, dhe gjuha është në pozicion mbivendosës ndaj dialektit, si realitet mesatar që gjendet afër dhe që, veç nga ana sasiore është më i shtrirë dhe i kuptueshëm». Për sa i përket frëngjishtes së Goldonit, Folena vëzhgon pastaj në mënyrë të mprehtë (*Ibid.*, f. 109) që bëhet fjalë për një «mbigjuhë abstrakte, [...] një përvojë stilistike, edhe ajo kryesisht e gjuhës së folur. [...] Një gjuhë edhe ajo e përvetsimit gojor më parë se të shkruar, por e zotëruar në mënyrë mimetike në sintaksën dhe në thelbin e saj të shekullit XVIII: thelbi, madje ndonjëherë karrikatura e frëngjishtes, një frëngjishte më shumë se frëngjishte».

toskanisht (tashmë me statusin e 'italishtes' *tout-court* si p.sh. *Gerusalemme liberata* ('Jeruzalemi i çliruar') dhe se ende në venecianisht mbaheshin normalisht fjalimet publike dhe private. Deri në rënien e Republikës – sipas dëshmisë që përmbajnë *Arringhe* ("Mbrotjtet publike") të Leopoldo Curti-t, të shtypura në Venecia në 1775 dhe të cituara nga Vianello⁵⁵:

një fisniku venecian që do t'i duhet të arsyetojë në cilëndo hapësirë publike, do ta humbiste aftësinë e tij bindëse, përveçse vlefshmërinë dhe forcën, por dhe vetë seriozitetin, nëse do të donte të shtirej me stërhollime zërash apo stilesh, apo nëse do të tregonte se turpërohej nga dialekti i vendit të tij.

Megjithëse Cortelazzo⁵⁶ sjell në vëmendje se «Duke u nisur nga shekulli XVI [...] në Venecia mbretëron ajo diglosi e pastër (e plotë) që zgjat deri në ditët tona; *il dialetto è riservato al parlato, l'italiano allo scritto* (dialekti i rezervohet të folurës, italishtja shkrimit) » dhe që (*Ibid.*, f. 73) «[...] venecianishtja [ishte] gjuhë e përbashkët që kuptohej dhe flitej nga të gjithë qytetarët e Republikës në çdo rast, me pak fjalë, po nuk ishte gjuhë zyrtare e shkresave publike, të shkruara».

3.1.1. Në qendrat e bregut të Adriatikut që shquhen për praninë politiko-administrative të *Serenissima*-s, venecianishtja – e nënkuptuar në varietetet diastratike, diafazike e diamezike – ishte një realitet gjuhësor me peshë të madhe: gjë që vazhdoi dhe me zvogëlimin e pushtetit politik të Republikës *marciana* së Venedikut. Më poshtë vë në pah dy situata, sipas meje emblematike: rasti i Dalmacisë dhe ai i Republikës së Shtatë Ishujve (*Heptanese*) grekë; kjo e fundit, jashtë kufijve gjeografike të Adriatikut është megjithatë thellësisht e lidhur me Adriatikon dhe sidomos me Venedikun për shumë shekuj.

Vazhdimësia në *continuum* e romanëve në gjuhë vulgare në Dalmaci, të përcaktuar qysh në shekullin XVI nga historiani dalmat Giovanni Lucio në veprën *De Regno Dalmatiae et Croatiae* që doli në Amsterdam në 1666 si sistem «[...] më afër gjuhës së piçenëve dhe puljezëve se sa me atë të venedikasve apo lombardëve»⁵⁷ dhe, për këtë arsye, të ndjerë plotësisht

55 N. VIANELLO, 1957, *Il veneziano lingua del foro veneto nella seconda metà del sec. XVIII*, «Lingua Nostra», 18 (1957), f. 72. Vërejtje interesante për përdorimet gjuhësore në gjykatat venedikase, ashtu siç duken të dokumentuara në komedinë goldoniane, gjenden në N. VIANELLO, *La lingua del foro veneto nelle attestazioni dell'opera goldoniana*, «Studi Goldoniani», 2 (1960), f. 909-928.

56 CORTELAZZO, *Il veneziano, lingua ufficiale*, f. 72.

57 Gjithsesi G. FOLENA, *Introduzione al veneziano 'de là da mar'*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 10-12 (1968-1970), f. 351-352, për sa i përket teksteve të para vulgare të ruajtura në vëllimet e Arkivit të Raguzës dhe që mund të vendosen rreth 1280, vëzhgon se gjuha e tyre bazohet në «[...] përdorim të shkruar të dialektit tashmë të konsoliduar dhe me traditë në praktikën e përditshme, edhe se pak i karakterizuar

si pjesë e arealit të Rumanisë Lindore, iu nënshtrua një procesi të thellë venetizimi (dhe paralelisht me të, por në masën më të madhe nëpërmjet rrugëve të tjera, italianizimi/toskanizimi) në atë masë që tipari dalmatian i rrethinave u zbeh dalëngadalë dhe dalmatishtja pati një gjëllim brenda grupeve të familjeve fisnike të cilat e përdornin të folmen e tyre tradicionale vetëm në raste formale.

Bartoli⁵⁸ na informon se në Raguzë, gjykatës dhe avokatë të 'regjencës' ('këshillit') së qytetit ishin të detyruar të përdornin dalmatishten në debatet dhe çështjet juridike dhe se ata ishin të detyruar, pra, të përdornin në të folur një gjuhë e cila, në shekujt pararendës, ishte përdorur dhe në formë të shkruar, si në shkresat publike, ashtu dhe në ushtrimin e tregtisë. Në fakt një qëndrim i tillë pasqyronte një marrëveshje tipike edhe të fisnikërisë së mesme venedikase, e ngarkuar vijimisht me detyra në Këshillin e Lartë të Gjykatës së Venedikut (*Consiglio della Quarantia Criminale*), derisa ende në Venedikun e shekullit XVIII – siç sjellin në mend Tomasin⁵⁹ e Ferguson⁶⁰ - aktiviteti i gjykatës zhvillohej thujse vetëm në dialekt.

Dalmatishtja humbi terren në favor të venecianishtes – bëhet fjalë edhe për atë që konsiderohet *facies* koloniale, gjuhë e marinarëve dhe trafiqueve tregtare⁶¹ – dhe, po ashtu u rrudh në përdorim përkundrejt dialekteve kroate kur, në shekujt XVI - XVII, bregu dalmat pësoi një mërgim të fortë sllavësh të cilët, të kërcënuar në truall ballkanik nga pushtuesi turk, kërkonin shpëtim në tokat e krishtera të mbrojtura nga Republika e Venedikut.

Një relacion anonim i 1555 – cituar prej Metzeltin⁶² – jep disa informacione interesante përreth dygjuhësisë 'schiafone' ('sllavisht')/ 'italisht' veçori e Raguzës:

[*cit.më lart në Raguzë*] Përdorin gratë gjuhën sllave, me të cilën komunikojnë dalmatët e tjerë, por burrat dhe këtë edhe italishten. Gjuha e tyre e lindjes është sllave, me të cilën flasin dalmatët e tjerë;

në tipare nga pikëpamje lokale, ende i paprekur nga ndikimet e dukshme veneciane dhe në një masë i lidhur kulturalisht me *scriptae* të bregut tjetër të Adriatikut dhe të Italisë Jugore [...]. Tjetër është gjendja e dokumenteve raguzane që prej shekullit XIII ku vulgarja duket të jetë në fakt kryesisht me bazë veneciane, ndonëse me gjurmë venedikase «jo veneciane», me gjurmë të dalmatishtes dhe, në përgjithësi, me një ndjesi në rritje të toskanitetit».

58 M. BARTOLI, *Das Dalmatische. Altromanische Sprachreste von Veglia bis Ragusa und ihre Stellung in der apennino-balkanischen Romania*. II: *Glossare und Texte - Grammatik und Lexikon*, Wien 1906, f. 221-224.

59 L. TOMASIN, *Il volgare e la legge. Storia linguistica del diritto veneziano (secoli XIII-XVIII)*, Padova 2001, f. 237.

60 R. FERGUSON, *A linguistic history of Venice*, Firenze 2007, f. 232.

61 F. BRUNI, *Lingua d'oltremare. Sulle tracce del 'Levant Italian' in età preunitaria*, «Lingua nostra», 60, 3-4 (1999), f. 78.

62 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 557.

flasin ende gjuhën italiane me fjalë të dëmtuara, për këtë arsye një pjesë përdorin fjalë të pastra toskane dhe një pjesë tjetër të pastra veneciane të lashta, një pjesë lombarde dhe një pjesë puljeze.

Një shekull më vonë, G. Leti, në veprën e tij *L'Italia regnante* (vol. III, I: 39) që doli në Gjenevë në 1676 dhe u citua nga Bartoli⁶³, përshkruan në të njëjtën mënyrë situatën gjuhësore të Raguzës me këto fjalë:

Gjuha italiane që raguzanët e quajnë *franca* ('e lirë') flitet me shumë entuziazëm midis burrave, madje nuk pranojnë asgjë para cilitdo gjykatësi që nuk di ta flasë, por megjithëse të rinjtë ushtrohen shumë, është fakt se zakonisht midis tyre flasin gjuhën e nënës që është thujse e gjitha si *schiafona* ("sllavishtja").

Nga ana tjetër, në kulm të klimës së kundërreformës dhe si rezultat i ndikimit të katolicizmit roman, Republika e Raguzës adoptoi si gjuhë zyrtare italishten e cila, që nga ai moment, bashkëjetoj me kroacishten që flitej nga shumica e popullsisë. Një relacion anonim i shekullit XVIII, cituar prej Metzeltin⁶⁴, pohon:

Gjuha vulgare që flitet në Raguzë dhe në shtet, është ajo ilirike. Shtresat e ulëta të popullsisë nuk flasin dhe nuk kuptojnë tjetër përveç kësaj; përveç pak prej tyre, që kanë pak njohuri nga italishtja. Por fisnikët i zotërojnë të dyja këto gjuhë. Italishtja e tyre është një përzierje e dialektit roman të dëmtuar nga shqiptimi dhe i ndonjë emërtimi napolitan, që të përzier bashkë formojnë një gjuhë, që ka një lloj hijeshie të vetën, të veçantë.

Në kulmin e shekullit XIX, N. Battaglini, në komentin që i bëri përkthimit në raguzanisht të novelës së parë të *Decamerone*, shkruante⁶⁵:

E re dhe e çuditshme për disa lexues do të jetë kur të zbulojnë, se si në kufirin e jashtëm thujse të Dalmacisë së sotme, dy milje larg nga kufiri otoman, nga një popullsi me shumicë apo të gjithë me origjinë sllave, të flitet veç ilirishtes edhe italishtja dhe kjo aq e rrjedhshme dhe e pastër, sa të dalë fituese në krahasim me shumë vende të vetë Toskanës.

Megjithëse, po të merret parasysh Muljačić⁶⁶, bëhej fjalë për një italishte me tipare të dallueshme rajonale, të paktën në nivel mbisegmentor, të karakterizuara nga një zhvendosje e vazhdueshme mbrapsht e theksit. Dhe dallon një shembull të çuditshëm: *se – vòlete àndare a – pàsedzo, prèndete il – kàpelo*.

63 BARTOLI, *Das Dalmatische*, I, f. 210.

64 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 321.

65 N. BATTAGLINI, *I parlari italiani in Certaldo alla festa del V centenario di messere Giovanni Boccaccio. Omaggio a G. Papanti*, Livorno 1875, f. 605.

66 Ž. MULJAČIĆ, Su alcuni toscanismi antichi nel dialetto croato di Dubrovnik, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 9-17.

Edhe Deanović-i⁶⁷ nënvizon faktin se, ndryshe nga ç'kishte ndodhur në bregun lindor të Adriatikut, që për shekuj me radhë kishte qenë në zotërimin e Republikës së Venedikut e ku ishte përhapur gjerësisht venecianishtja, kjo e fundit:

[...] nuk depërtoi kurrë në Raguzën e pavarur [...ku] njerëzit e shkolluar, krah sllavishtes, njihnin vetëm italishten letrare (toskanishten) të mësuar në shkollë dhe të përdorur krah latinishtes në jetën publike.

Pak a shumë e ngjashme duhej të ishte edhe gjendja e Istrias ku për shekuj me radhë kanë bashkëjetuar 'italishtja' dhe 'sllavishtja'. Valvasor, i cituar nga Metzeltin⁶⁸, jep konsiderata – ishte viti 1808 – rreth situatës gjuhësore të banorëve të Istrias austriake:

[...] fiumanët, dalmatët apo liburnët banojnë në Dalmaci apo Liburnia [...]. Gjuha e tyre është dalmatishtja. Banorët e tjerë janë *istriane* e *vërtetë* që kanë zaptuar Pisinon, përveç qytetet e vogla dhe truallët.

Gjuha e tyre është ajo istriane, d.m.th. një italishte e keqe, apo *Welsch*.

Zona të tjera të Dalmacisë, të konsideruara nga kozmografët e lashtë si qytete ku lulëzon 'italianizmi' – nga Zara në Shebenik, nga Spalato në ishujt Brazza, Lesina, Lissa, Curzola, nga Perazzi në Cattaro – kishin pësuar të njëjtin fat: nga qendra romane të dalmatinizmit dhe më pas të venecianizmit, njësoj si Raguza ishin sllavizuar dalëngadalë, ndonëse Tommaseo, nga ana e tij do të lëvdojë italishten e kristaltë që dëgjonte të flitej në Shebenik dhe Korfuz⁶⁹.

[...] mund të thuhet se disa baronë dhe markezë napolitanë apo toskanë flasin italisht më pak të pastër se gruaja e thjeshtë e Korfuzit dhe Shebenikut.

3.1.2. Jo shumë ndryshe nga situata raguzane do duhet të ishte ajo e ishullit Velja dhe ishujve të afërt me të, Cherso, Lussino e Arbe: kalimi në varësinë venedikase vetëm nga shekulli XVI dhe qëndrimi nën administratën venedikase në një fazë që shënonte rënien e saj të vazhdueshme, 'venetizimi' i tyre, që vetëm i pjesshëm dhe kjo shpjegon qëndrueshmërinë e dalmatishtes në ato zona si gjuhë në përdorim ende në shekujt XVIII - XIX. Por është gjithashtu interesante të vihet në dukje se, në ndërgjegjen gjuhësore të folësve të dalmatishtes, një sistem i tillë identifikohet si pjesë përbërëse e një hapësire gjuhësore ku i *continua* gjuhësorë mes 'italishtes' dhe 'venecianishtes' nënkuptoheshin në masën më të mirë si të mbishtresëzuara njëra me tjetrën. Në lidhje me këtë është

67 M. DEANOVIĆ, *Carattere mediterraneo della parlata di Ragusa*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 1.

68 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 321.

69 N. TOMMASEO, *Dizionario di estetica*, I, Milano 1860³, f. 162.

interesante një dëshmi e mëtejshme e Bartoli-t⁷⁰ i cili dëgjoi nga një dalmat i ishullit Krk-ut/Veljës t'i përgjigjej pyetjes së tij «Come si parla oggi a Veglia?» («Si flitet sot në Veljë?»): «Se parla talian, sior, anzi venezian» («Flitet italisht, zotëri, madje venecianisht»); dhe po Bartoli⁷¹ dëshmon se folësit e Veljës në fund të shekullit XIX e quanin veten 'Italiani': "ne në qytetin e Veljës jemi të gjithë italianë [...] ne italianët e Veljës."

3.1.3. Mjaft e ngjashme ishte gjendja edhe në ishujt e Heptanezit grek. Për shekuj me radhë nën sundimin e Serenissima-s (duke filluar nga viti 1386) dhe i lidhur me të deri në 1797, ishujt jonianë u venecianizuan thellësisht (dhe, pikërisht nëpërmjet dialektit venecian u italianizuan, pjesërisht). Për më tepër, kur mbërritën venedikasin, në Korfuz gjendej prej kohësh tashmë një bashkësi italianësh ardhur nga qytete të ndryshme të gadishullit italik. Gjendej, po ashtu, edhe një bashkësi hebrenjsh ardhur nga Italia Jugore⁷². Përbërja shoqërore e mjedisit korfjot dhe prestigji që gëzonte në Korfuz, bënë që italishtja 'e lartë' të ishte gjuha zyrtare e ishullit, ndonëse përdorimi i greqishtes së re nuk reshti kurrë, falë rolit gjuhësor-kulturor që luajti kisha ortodokse dhe falë tolerancës gjuhësore të sundimtarëve. Ikonomou⁷³ shprehet kështu:

[...] në Korfuz kultura dhe gjuha italishte mbisundonin. Italishtja përdorej në teatër dhe parapëlqejë që vjershat të shkruheshin në atë gjuhë. Ishte gjuha e intelektualëve që kishin studjuar në universitetet italiane, nga Padova në Pavia e deri në Napoli. Ishte, pra, gjuha e fushës juridike në të cilën shtypeshin ligjet dhe flisnin avokatët; ishte gjuha e mjekësisë, sepse mjekët korfjotë kishin studjuar në Itali. Ishte gjithashtu gjuha e tregtarëve të të gjithë pellgut të Adriatikut dhe Jonit, më shumë se greqishtja dhe frëngjishtja; ishte gjuha e fisnikëve korfjotë, të cilët, shpesh me zanafillë venedikase, shihnin nga ai qytet me mall dhe me melankoni.

Kështu, pra, më shumë se italishtja, dialekti venecian, mbi të gjitha varianti i lartë i kësaj shkalle gjuhësore, ishte gjuha e shtresave të larta të popullsisë, ose më mirë të themi të atij segmenti shoqëror, i cili për një kohë të gjatë e quajti variantin dialektik romeik të greqishtes së re të folur në Heptanez si diçka e cila e turpëronte, dhe që, përkundrazi, donte të dallohej nga vegjëlia pikërisht sepse dinte dhe donte të fliste dialektin venecian.

Aristokracia e Heptanezit, ('domethënë e këtyre Shtatë Ishujve në detin Jon'), ishte e përfshirë në "Librin e Artë" të aristokracisë venedikase dhe

70 BARTOLI, *Das Dalmatische*, II, f. 59.

71 *Ibid.*, f. 60.

72 GALEAZZO, *Voci italiane e veneziane*, f. 84.

73 IKONOMOU, *Le isole ionie, la Grecia*, f. 280-281.

e shikonte Venedikun si kryeqytetin e vet, duke e interpretuar si një urë drejt Evropës dhe tharreve të saj kulturore, si një shteg për të dalë nga dara e kërcënimit turk⁷⁴. Përsa i përket madje përhapjes së gjuhës italishte në ishujt e Heptanezit, Gozzi⁷⁵ shënon se në ishujt jonianë, të cilët në 1797 kaluan nga sundimi venedikas në protektoratin francez (dhe pastaj nga 1809 e deri në 1814 nën atë anglez, e që ky i fundit zgjati deri në 1864), administrimi i drejtësisë u zhvillua në gjuhën italishte⁷⁶ përgjatë gjithë gjysmës së parë të tetëqindëshit dhe prapë, deri në gjysmën e shek. XIX panorama gjuhësore e ishujve jonianë dallohej thellësisht nga ndikimi venedikas. Kështu, në lidhje me këtë, Stamatopulos⁷⁷ shprehet:

Sundimi i gjatë venedikas [në ishujt jonianë] ushtroi një ndikim të theksuar në gjuhën vendase greke, e cila, mbasi që kishte qëndruar relativisht gjatë e pandryshuar për shekuj me radhë, tashti përfshi u në gjirin e saj një sërë fjalësh nga italishtja dhe venecianishtja e folur [...] të cilat u helenizuan për nga forma gramatikore. Italishtja ose venecianishtja u përdor nga popullata vetëm nga klasat e kulturuar, të cilat ose e mbajtën kontaktin me autoritetet, ose, kishin fituar nëpërmjet studimeve në Itali, mënyrën e të shprehurit, në shkrim dhe në këndim, koncepte kulturore të cilat nga mungesa e arsimit greqisht, këta mendonin se ishin të paaftë t'i shprehnin në gjuhën e tyre amtare. Përveç përdorimit vetjak ose të veçantë të greqishtes, të një gjuhe pjesërisht të italianizuar, mund të shtojmë se greqishtja u përdorte pothuajse përgjithësisht në dokumentet ligjore që individët lidhnin ose ndër testamentet që vendosnin rend në çështjet kishtarë.

Gjatë periudhës së protektoratit britanik dhe, edhe ndonjë vit mbasi që ishujt jonianë kishin hyrë në përbërjen e mbretërisë greke, italishtja (dhe

74 Domethënëse është, në lidhje me këtë pikë, të përhapurit në Heptanez e modeleve teatrale tipike venedikase, përveç përkthimeve në greqishten e re të veprave të Goldonit. A. BACOPOULOU-HALLS, *Modern Greek Theater: Roots and Blossoms*, Athens, 1982, f. 54-56 përmend se «[...] the *libro d'oro* youths staged their performances for the nobili in the *porteghi* and in the *da ricevere* rooms of the *palazzi*».

75 G. GOZZI, *Diritto veneto e lingua italiana nelle Isole Jonie nella prima metà dell'ottocento*, në *Omaggio a Gianfranco Folena*, Padova 1993, II, f. 1533-1547.

76 Por jo pa kundërshtime ama. Kundër përdorimit të italishtes në fushën e drejtësisë në territoret joniane, u shpreh haptas edhe N. TOMMASEO, *Il supplizio di un italiano in Corfù, Introduzione e note di F. Danelon, con uno studio di Tz. Ikonou*, Venezia 2008, f. 181-196. Tommaseo u shndërrua në një mbrojtës së përdorimit të greqishtes së gjallë, që flitej nga populli dhe u shpreh haptas kundër përdorimit pedant dhe ripërtëritjes së greqishtes së lashtë duke e kthyer në greqishte 'zyrtare'. Duke vepruar kështu përmendte kompetencën e Fauriel-it (krh. N. TOMMASEO, *po aty.*, f. 195). Rreth kësaj çështjeje, lajme të sakta gjenden në F. DANELON, *Introduzione*, në N. TOMMASEO, *Il supplizio di un italiano in Corfù, me parathënie dhe shënime të F. Danelon*, me një studim të Tz. Ikonou, Venezia 2008, f. 39-40.

77 N. STAMATOPOULOS, *Old Corfu. History and Culture*, Athens, 1993.

jo vetëm venecianishtja) ishte gjuha e përdorur në veprimtarinë ligjvënëse dhe juridike, si në fushën civile ashtu edhe në atë penale. Dalngadalë pastaj e arritën edhe anglishtja dhe greqishtja. Por kalimi në greqishte nuk qe aspak i rrufeshëm, sepse – sikurse me të drejtë na vë në dukje Gozzi⁷⁸ – ndërimi i gjuhës u shoqërua edhe me ndryshime në zgjedhjen e praktikave juridike. Prapë këtui, është e rëndësishme dëshmia e Tommaseo-ut⁷⁹: ky e kishte kuptuar mirë gjendjen e vështirë dhe të ndërlikuar gjuhësore në territorin heptanezas, dhe në lidhje me debatin rreth futjes së greqishtes, që ai mbështeste, në përdorim publik dhe zyrtar, vinte në dukje “skizmen” që vetë grekët po shkaktonin në gjuhën e tyre.

Gjithashtu, nuk munguan në hapsirën territoriale heptanezase në vitet që do të rridhnin ose menjëherë pas bashkimit të ishujve jonianë me dheun mëmë, tharmet nacionaliste (edhe ato të llojit gjuhësor), të cilat ndërsa mbështesnin përdorimin e greqishtes, kundërshtonin italishten.

Është interesante në këtë pikë, denoncimi i Mustoxidi-t⁸⁰:

Qytetari [heptanezasi] e sheh vetën në gjykatë, kur akuzohet, mbrohet, gjykohet për pronën, dhe dënohet me liri dhe me jetë në një gjuhë [në italisht] që nuk e njeh dhe simbas ligjeve të cilat as nuk ia kanë përkthyer kurrë. Katundari vjen në qytet, kërkon emrin e rrugëve, por tabelat nuk i shërbejnë kujt tjetër veçse sicilianëve dhe maltezëve. Populli është grek, gjuha e tij është greqishtja, gjuha e etërve të tij, gjuha e ndjenjave, gjuha e kontratave, e fesë së tij, interpretuesja e muzave dhe e hyjneshave [...] Pse u dashka atëherë që kjo të nxirret jashtë ligjit dhe të përçmohet në vendlindjen e saj [...] Sepse një pjesë e atyre që kanë monopolin e pronës publike, si mbetje ose pasojë e arsimit venedikas, flasin [...] gjuhën e Arlekinut dhe të Pantalone-s. Dhe për këta tridhjetë vetë që belbëzojnë në italisht, sakrifkohet hijeshia e mbarë një populli dhe interesat e gati dyqind mijë banorëve.

Kundër kësaj gjendjeje, Tommaseo, një mbështetës i singjertë i pavarësisë të të gjitha kombeve të shtypura, ftonte intelektualët e Heptanezit dhe të mbretërisë së re të Greqisë që të përdornin greqishten në fushat e larta e të kontrollueshme të jetës, por që në të njëjtën kohë të mos djallonin italishten. Italianët dhe grekët i dukeshin në të njëjtin rrafsh, ngaqë ishin popuj të shtypur për një kohë të gjatë dhe kështu që i dukej e pëlqyeshme

78 GOZZI, *Diritto veneto e lingua italiana*, f. 1533-1547.

79 TOMMASEO, *Il supplizio d'un italiano in Corfù*, f. 181-196.

80 A. MUSTOXIDI, *Promemoria sulla condizione attuale delle Isole Ionie. Presentato privatamente in Londra nel mese di Agosto 1839. Dal cavaliere Andrea Mustoxidi, C.S.M.S.G. e membro del Parlamento degli Stati Ioni a sua signoria il ministro delle colonie* [markezi Normanby], *coll'aggiunta ora di alcune note e delle lettere del cavaliere Mustoxidi a Lord Normanby e Lord John Russell*, Londra 1840, f. 9.

një sintoni e fortë e tyre kulturore. Ja si shprehej Tommaseo⁸¹:

Nëse italianët do të kishin qenë fitimtarët dhe të fuqishmit, do të kishte qenë me vend t'i mbanit sytë katër, dhe guximi për të mos ua vënë veshin do të dukej i bukur dhe krenaria me vend. Por fati i keq i ka përndjekur këta, kështu që po ua porosis. Ju [intelektualët grekë] nuk jeni as aq të mëdhenj e as aq të fuqishëm sa të përçmoni ndokënd. Dhe ata që janë të fuqishëm, nuk e përbuzin aleancën ndër fatkeqësi dhe vëllazërinë e shenjtë ndër dhimbje, pa u ndëshkuar.

3.1.4. Rishtas, Venediku u bë poli i përhapjes së një letërsie mjaft domethënëse të llojit humanist, e cila lulëzoi në territorin dalmat (në Raguzë, posaçërisht) ku latinishtja, në versionin e saj të humanizmit të vonë, krahas italishtes u përdorën qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë si gjuhë letrare, ose në mënyrë të tërthortë, në territore ku fliteshin dy gjuhë: sllavo-romane. Këto të dyja shërbyen si gjuhë model për elitat e Dalmacisë kroate dhe venedikase për vepra poetike në gjuhët sllave, kroatisht ose serbisht. Jehona e poetëve të shek. XVI (Petar Zoranić, imitues i "Arkadies" së Jacopo Sannazaro-s; Frano Lukarević, përkthyes i "Pastor fido" i Battista Guarini-t; Hanibal Lucić, petrarkist, dhe e atyre të shek. XVII (Džon Palmotić, poet dhe dramaturg në latinisht dhe në serbisht) mbërriti pa u zbehur në shekujt që rrodhën duke dëshmuar për një atmosferë kulturore në të cilën Venediku dhe italianët e ditur kishin luajtur dhe ende po luanin një rol të rëndësishëm në shek. XVIII - XIX.

Po ashtu nuk duhet anashkaluar fakti, gjithnjë duke ndjekur Vratović-in⁸², se pikërisht gjatë kalimit nga shek. XVIII në shek. XIX dhe gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të këtij të fundit, disa nga latinistët e Raguzës – si ata që shkruanin përveç se në latinisht edhe në kroatisht (p.sh. Ferić, Bruerević), ashtu edhe ata që shkruanin vetëm në latinisht (p.sh. Džamanjić) – në marrëdhënie personale dhe bashkëpunim letrar, duke shfaqur paraprakisht edhe prirje ideologjike e nacionale dhe estetike, kontribuan në drejtimin e së ashtuquajturës Lëvizja Ilirike (kro. *Ilirski Preporod*), me fjalë të tjera, për lëvizjen e rilindjes kroate (kro. *Hrvatski preporod*) të viteve tridhjetë të shek. XIX.

3.1.5. Përveç Venedikut, luajti rol domethënës edhe mjedisi romak i Kundërreformës, falë veprimtarisë së vëllazërive rregulltare (jezuitët, françeskanët, paulinët, dominikanët) të cilët, në territoret ballkanike ku kishte katolicizëm (në Dalmacinë sllavo-venedikase, në Arbërinë Veriore; pjesërisht edhe në Bosnje) jo vetëm kontribuan në përhapjen

81 N. TOMMASEO, *Dizionario estetico*, Firenze 18674, col. 313.

82 V. VRATOVIĆ, *Riflessi mediterranei presso i latinisti croati*, «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), f. 123-127.

qoftë të latinishtes, qoftë të italishtes letrare, por, edhe falë pikërisht këtyre modeleve, mbështetën pjesërisht edhe procesin e emancipimit të folësve kroatë, serbë, boshnjakë kundrejt gjuhës së tyre kryesore që ishte sllavishtja kishtare (ose sllavishtja e përditshme).

Duhet përmendur se ende, në shek. XVIII dhe në gjysmën e parë të shek. XIX, një pjesë e mirë e bijve të klasave të kamura të qyteteve në bregun lindor të Adriatikut dhe të Heptanezit jonian, studionin në Itali, kryesisht në Padovë, por edhe në Pavia, Pizë, Bolonjë. Bëhet fjalë për mjedise në të cilat u formuan, mes të tjerëve, edhe dy kampione të letrave të larta, përkatësisht, italiane dhe neogreke: Ugo Foscolo dhe Dionisios Solomos, shembuj interesantë dhe mjaft të afirmuar të kësaj atmosfere⁸³.

Foscolo-ja nga Ksanti, greqishtfolës dhe pjesërisht venecianishtfolës (dhe mbase edhe kompetent i asaj që kishte mbijetuar nga dalmatinishtja: i ati ishte nga Spliti dhe, prapë, Foscolo, në moshë të re pati studiuar katër vjet në Split.), ndonëse e mbajti gjallë ndjenjën e tij të përkatësisë së botës neogreke⁸⁴, e njihte para se të mbërrinte në Venedik – ai pak më shumë se adoleshent – toskanishten e lartë të cilën e kishte studjuar duke filluar nga viti 1785 në seminarin e Splitit dhe të cilën brenda pak kohe arriti ta zotëronte në një mënyrë të mrekullueshme⁸⁵, aq sa u bë poeti i lartë i një Italie e cila ishte ende e ndarë politikisht. Kështu e ravijëzon Terzoli⁸⁶ portretin socio-gjuhësor të Foscolo-s të ri, kur vuri këmbë në Venedik:

Djaloshi pesëmbëdhjetëvjeçar, me nënë greke, i cili mbërriti në Venedik katër vjet pas vdekjes të t'et, fliste greqishten moderne dhe dialektin e Ksantit, dhe ndoshta deri diku edhe dialektin venecian që kishte trashëguar nga familja atnore. Italishten e kishte studiuar si gjuhë të shkruar, gjuhë të kulturës gjatë atyre pak viteve që pati kaluar në seminarin e Splitit. Rrallëherë i binte ta përdorte – sigurisht që nuk e fliste rregullisht – në mjedisin e greqishtes së re ku ishte rritur.

83 Në të cilën morën pjesë edhe intelektualë të tjerë heptanezas, po përmend mes të tjerëve Niccolo Delvinjoti, Andrea Mustoxidi, Mario Pieri, Spiridione Petrettini. Këtë dell kulturor e dëshmojnë edhe revistat korfuzase të botuara në italisht: *Gazzetta Ionia*, *Monitore Ionio*, *Gazzetta degli Stati Uniti delle Isole Ionie*.

84 M. A. TERZOLI, *Foscolo*, Roma-Bari 2000, f. 172-173 përmend se si Foscolo i shkroi gjithëherë s'ëmës në greqishten e re, e cila, përpos tjerash, nuk dinte të lexonte në alfabetin latin. Pra, greqishtja e re që flitej në Ksant qe gjithmonë për të gjuhë "amtare" në kuptimin e thellë të fjalës, aq sa shfaqet ende, kur ishte tashmë i pjekur, në disa letra të tij drejtuar familjarëve.

85 Vitit 1785 i përkasin edhe disa vjersha që Foscolo i shkoi në toskanishten e lartë, e të cilat ua kushtoi letrarëve, dhe miqve. Në vjeshtën e po atij viti, poeti fare i ri, njoftonte Cesarotti-n se kishte plotësuar "Tieste"-n, një tragjedi me rremb alferian, e cila pastaj u pat vënë në skenë për herë të parë më 4 janar 1797 në teatrin Sant'Angelo të Venedikut. Foscolo-ja nuk i kishte mbushur ende të nëntëmbëdhjetat.

86 M. A. TERZOLI, *Foscolo*, f. 169.

Solomòs, edhe ky ksantas me origjinë dhe pastaj korfuzas, i cili pastaj u bë edhe poeti i lartë i Greqisë moderne, shkruante edhe ky në një toskanishte të lartë dhe në mënyrë paradoksale, u ftua që t'i sillte në greqishten e re vargjet e tij të menduara dhe të shkruara në italisht. Vepra e tij e famshme letrare *Σὲ γνωρίζω ἀπὸ τὴν κόψι*, dy strofat e para të së cilës u bënë pastaj himni kombëtar grek, në rrënjë fillimisht qe një vjershë e llojit krejtësisht italian, me një shije të pastër manzoniane. Kështu shprehet Ikonomou⁸⁷ në lidhje me “fillimet” dhe me veprimtarinë e ndërlikuar poetike të Solomòs-it:

Fillimet e Solomòs-it qenë pra në italisht. Historia se si nisi të shkruante greqisht është mjaft interesante për të kuptuar kulturën jonike të kohës. Në një takim në vitin 1822 me Spiridion Trikoupi, poeti i ri recitoi një vjershë në italisht. Trikoupi reagoi ndaj leximit të “Odë për Meshën e Parë” dhe e grishi të vjershëronte greqisht, ngaqë Parnasi italian, ku padyshim do të kishte merituar një vend, ishte tashmë plot me emra të ndritur, ndërsa ai grek ende nuk e kishte gjetur Alighierin e vet. Ky episod, diçka ndërmjet mitit dhe realitetit, qe fillimi i një karriere të rëndësishme, sepse pak më vonë Solomòs-i shkroi “Himnin e lirisë” i cili e bëri të famshëm. Megjithëse njihet si poeti kombëtar grek, prodhimtaria e tij poetike, fatkeqësisht, është e pamjaftueshme [...]. Solomòsi në të vërtetë nuk arriti ta përfundonte shumicën e veprave të tij.

Te Solomòs-i binte në sy një dygjuhësi e vërtetë dhe vepruese: italishtja kishte zënë rrënjë tek ai madje edhe më mirë se greqishtja dhe duhet konsideruar pra, si gjuha e tij e parë e vërtetë. Arsimimi i tij kishte qenë krejtësisht italian, fillimisht në Kremonë dhe pastaj në Pavia. Pat shkruar në fillim rima të improvizuara në italisht dhe vetëm më vonë provoi të vjershëronte në greqisht. Para se të vdiste, iu kthye edhe njëherë shkrimit italisht dhe sa e rëndësishme qe për të italishtja, kuptohet fare mirë nga shqyrtimi i kartave të tij, nga të cilat del se ai fillimisht hidhte në letër një keqeshkrojtë të çfarëdolloj veprë në italisht dhe pastaj e sillte greqisht. Edhe korrespondenca e tij është fillim e mbarim italisht, sikurse e ka dëshmuar mirë edhe V. Rotolo⁸⁸.

Një tjetër bir i Heptanezit, letrari dhe historiani korfjot Mario Pieri (1776-1852), po ashtu pyeste veten se cila ishte gjuha e tij amtare dhe e ngrinte problemin në këndvështrimin patriotik, duke përmendur edhe vështirësitë e hasura në jetën e tij⁸⁹:

87 IKONOMOU, *Le isole ionie, la Grecia*, f. 332-333.

88 V. ROTOLO, *Dionisios Solomòs fra la cultura italiana e la cultura greca*, «Italo-Ελληνικά», 4 (1991-1993), f. 102-103.

89 M. PIERI, *Sfortunato chi ha due patrie*, tek M. PIERI, *Opere varie inedite, originali e tradotte*, Firenze 1851, IV, . 359.

Njeriu [...] i cili ka dy atdhe, atë të lindjes dhe atë të zgjedhurin, përfundon pa asnjë, dhe mbetet i mërguar gjithë jetën e tij. [...] Edhe mua më ndodhi, jo rrallë, të gjendem i luatur ndër shkrimet e mia, pa guxuar të them atë “ne”-në fisnike dhe guximtare, duke menduar si italianë, ose duke e shprehur me njëfarë dyshimi se mos italianët do të m’i përplasnin në sy shtegtimet e mia e nga ana tjetër, me druajtje, se mos grekët shkandulloheshin dhe më quanin dezertor dhe tradhtar të atdheut tim të lashtë dhe të vërtetë.

Rreth rëndësisë dhe rolit të italishtes në territorin dalmat jo vetëm si gjuhë letrare, por edhe si gjuhë e shkencës, janë dëshmitarë edhe shkencëtarët dalmatë zëmëdhën, ndër të cilët qe Alessandro Paravia (1797-1857), profesor i elokuencës dhe Anton Maria Lorgna di Tenin (1736-1796), matematikan i shquar. E ngjashme ishte gjendja edhe në Istrië ku, sa për të kujtuar disa nga personalitetet që përdorën italishten letrare gjatë shek. XVIII - XIX, po përmend njëzëri me Metzeltin⁹⁰, iluministin Gian Rinaldo Carli (1720-1795), poetin Alessandro Gavardo (vdekur në 1818), autor i poemës heroiko-komike “La Rinaldeide” dhe në fund, poetin Francesco Combi (shek. XIX), përkthyes i çmuar i Virgilit.

3.1.6. Qe i dukshëm gjatë shekujve të sundimit venedikas në Adriatik dhe në Mesdheun Lindor, roli edhe i *Venedikut* si pol i përhapjes dhe i famës së italishtes si gjuhë e përdorur në mjedisin burokratiko-administrativ. Bruni⁹¹ e përmend këtë larmë si «gjuhë ndërveprimesh diplomatike, politike [...] me rrënjë toskane jo krejt të kulluar, me elemente të italishtes qendrore dhe jugore, mbase me ndonjë ndikim verior, dhe me ndërhyrje të gjuhëve të tjera mesdhetare [...]» dhe e dallon këtë nga përkufizimi i gjuhëtarit Gianfranco Folena ‘veneziana de là da mar’ ashtu si edhe nga ‘lingua franca’⁹².

Nuk qe i papërfillshëm, përse i përket fatit të kësaj shtrese gjuhësore, roli që luajtën edhe dragomanët (< ar. *tarğumān*), me fjalë të tjera, roli i përkthyesve në shërbim të Portës së Lartë, ndërmjetësues i perëndimorëve dhe administratës perandorake osmane: përpos italianëve (shpesh venedikas, të ashtuquajturit ‘giovani di lingua’), këta shpeshherë ishin grekë ose dalmatë, pinjoj të klasave të larta shoqërore të cilët shkonin

90 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 326.

91 BRUNI, *Lingua d'oltremare*, f. 70-72.

92 M. CORTELAZZO, *La conoscenza della lingua turca in Italia*, «Il Velto», 23, 2-4 (1979), f. 137 na njofton se senati venedikas kishte vendosur me një dekret në 1551 të themelohej pranë selisë së bajlozit të Venedikut në Stamboll «[...] una vera scuola di addestramento di lingua: ‘siano eletti dui nodali de la Cancelleria nostra, ovvero dui altri cittadini nostri [...] i quali siano di etade di anni vinti, et da li in su, i quali siano mandati a Costantinopoli in casa del Bailo nostro, con obbligazioni di imparare la lingua turca, legger et scriver in quell’idioma».

për të studiuar në shkollat dhe universitetet italiane⁹³ dhe ishin, kësisoj, krejtësisht të përfshirë në atë që Minervini⁹⁴ e përkufizon si «[...] politika koloniale venedikase, e prirë drejt asimilimit të elitave vendore në zotërimet e gjera të perandorisë detare tregtare [kupto: të *Venedikut*].

Një i tillë që edhe rasti i fanariotit Kostantin Kantakuzeni, zyrtar i pallatit dhe protagonist i rilindjes intelektuale rumune, autor i kartës së parë të Vllahisë, shtypur në Venedik në 1700; dhe më pak se një shekull më vonë, kështu ndodhi edhe me vëllezërit Nikolas dhe Frankiskos Karavellas, miq dhe letërkëmbyes me Lord Byron, studentë të universitetit të Padovës dhe të Pizës⁹⁵. Dëshmi të tjera më të sakta rreth rolit të rëndësishëm të italishtes burokratiko-administrative në zonën e Mesdheut Lindor dhe Perëndimor (dhe si pasojë edhe në atë të detit Adriatik) në shek. XVIII - XIX janë nga njëra anë teksti i traktatit ndërmjet Ruisë dhe Perandorisë Osmane, nënshkruar në qytetin bullgar Kùçuk-Kaynarca në korrikun e 1774-ës dhe përkthimi i lejes së posaçme lëshuar Lord Elgin-it në 1801 nga Porta e Lartë për restaurimin (në të vërtetë që fjala për heqjen brutale) të mermerëve të Partenonit (Bruni 1999: 70). Ndryshe nga traktatet e Karlowitz-t (1669) dhe të Passaroëitz-it (1718), të hartuara në latinisht, traktati i Kùçuk-Kaynarca u shkrua fillimisht në italisht dhe vetëm më pas u përkthye rusisht dhe në turqishten osmane. Minervini⁹⁶, duke e njohur rolin e italishtes si gjuhë e kontakteve politiko-diplomatike të Perandorisë Osmane me botën evropiane, me të drejtë nënvizon faktin se «[...] për këtë situatë ka kontribuar në mënyrë të dukshme dhe në shumë plane, përfshirja e Venedikut [...]», qendër e burokracisë shtetërore e rëndësishme dhe pikë referimi themelore në shkëmbimet diplomatike ndërmjet palës turko-osmane dhe fuqive të Evropës Perëndimore dhe Qendrore e Veriore.

Dhe këtu nuk është fjala për ngjarje të kufizuara. Bruni⁹⁷ na kujton me vend se italishtja ishte në përdorim si gjuhë veprimtarie tregtare dhe gjyqësore edhe në Tripoli të Libisë dhe në Tunizi dhe, madje edhe në konsullatat e Francës dhe të Britanisë së Madhe në Tripoli të Libisë

93 Rreth këtyre 'giovani di lingua' të cilët Republika e Venedikut i rekrutonte kryesisht në Dalmaci me qëllim që të formonte ndërmjetësues të besueshëm për negociatat me botën turko-osmane, në të gjitha fushat e jetës, krhs. BRUNI, *Per la vitalità dell'italiano preunitario*, f. 207, n. 35, me një bibliografi të pasur. Të dhëna të dobishme gjenden edhe te M. P. PEDANI, *Venezia porta d'oriente*, Bologna, 2010, f. 162-165.

94 L. MINERVINI, *L'italiano nell'impero ottomano*, në *Lo spazio linguistico italiano e le lingue 'esotiche'. Rapporti e reciproci influssi*. Atti del XXXIX Congresso internazionale di studi della Società di Linguistica Italiana (Milano, 22-24 settembre 2005), me përkujdesjen e E. BANFI – G. IANNACCARO, Roma 2006, f. 50.

95 BRUNI, *Lingua d'oltremare*, f. 67.

96 MINERVINI, *L'italiano nell'impero ottomano*, f. 58.

97 F. BRUNI, *Italiano all'estero e italiano sommerso: una lingua senza impero*, në *Storia della lingua e storia*, me përkujdesin e G. ALFIERI, Firenze 2003, f. 191.

dhe në Tunis. Lajmi, nxjerrë nga kërkime të rëndësishme arkivore kryer nga Joseph Cremona (një përmbledhje të të cilit gjejmë tek Cremona⁹⁸) vërtetohet edhe nga fakti se në periudhën e kryengritjes greke kundër turqve – e një kohe me atë të karbonarëve në Italinë e viteve 1820-1821 – italishtja ishte, sipas Brunit, «[...] gjuha më e përhapur ndër patriotët që rebeloheshin kundër sundimit turk»⁹⁹ dhe kjo ndodhte në një moment të theksuar ligështie politike të shteteve të veçanta dhe të shteteve të vogla të një Italia ende të copëzuar dhe të ndarë.

3.1.7. Përsëri Venediku që njëra nga qendrat themeluese të një varianti të italishtes nënstandarde, më e ulët në krahasim me italishten letrare, por e përhapur në mënyrë diatopike në Itali, dhe kështu që qëndronte mbi dialektet¹⁰⁰: ai variant i dyshtresëzuar të cilin Foscolo e përkufizon tek e pesta e Epokave të gjuhës italiane si:

[...] një lloj gjuhe e përbashkët, krejt e ndryshme për gjithçka nga dialektet krahinore dhe bashkiake, dhe që ruan disa nga veçoritë bastarde të të gjithave [...] që ne e tregojmë herë me emrin “udhëtuese” dhe herë si “tregtare”. [...] Një gjuhë që nevojat ia paraqesin njeriut në mënyrë të natyrshme, dhe prandaj është e krijuar krejt kollaj [...], por shpeshherë ndryshohet dhe shkatërrohet me po të njëjtën lehtësi.

Një variant që Foscolo, i cili e çoi fëmijërinë e vet sa në Ksant aq në Dalmaci, e njehsonte me gjuhën që njihet si “*lingua franca*”, të cilën ai e shihte të përhapur në mënyrë eksperimentale¹⁰¹ (*Saggi di letteratura italiana*, cit. fq 209.):

[...] në të gjitha brigjet e Mesdheut deri në Konstandinopojë [...] dhe nëpërmjet saj, tregtarët e çdo feje dhe kombësie merren vesh nëpër panairot ku dynden për të tregtuar.

Ky variant ishte mjaft i pranishëm edhe te një personalitet tjetër i kulturës përtjeadriatikase, Niccolò Tommaseo, kur shkruante në *Fjalorin estetik*¹⁰² të tij se:

italishtja ka qenë dhe është ende sot në Levant gjuha e tregtisë, shumë më popullore nga ç’është frëngjishtja, edhe në Levant edhe në pjesën tjetër të Evropës;

dhe kur, pikërisht në lidhje me traditat e komunikimit gjuhësor në

98 J. CREMONA, *L’italiano dell’Africa settentrionale sei e settecentesca nella storiografia del Mediterraneo*, në *Storia della lingua e storia*, me përkujdesin e G. ALFIERI, Firenze 2003, f. 199-209.

99 BRUNI, *Italiano all’estero e italiano sommerso*, f. 192.

100 BRUNI, *Per la vitalità dell’italiano preunitario*, f. 201.

101 U. FOSCOLO, *Saggi di letteratura italiana* (citim marrë nga BRUNI, *Per la vitalità dell’italiano*, f. 209).

102 N. TOMMASEO, *Dizionario estetico*, Milano 1853, f. 159.

lundrimin në Adriatik dhe në Mesdhe, vetë Tommaseo pohon se italishtja zë vendin e parë si gjuhë e lundrimit¹⁰³:

Nëpër Adriatik dhe shumicën e brigjeve të Mesdheut lundrohet sidoqoftë duke përdorur italishten më mirë se me greqishten dhe me frëngjishten, që nuk është gjuhë popujsh.

Fati i këtij varianti varej, kryesisht, siç vinte në dukje Bruni¹⁰⁴, nga fakti se italishtja ishte stabilizuar si gjuhë letrare shumë më herët dhe më qëndrueshëm se gjuhët e tjera evropiane, romane dhe gjermanike. Natyrisht, ata që çanin rrugët detare dhe tregtare të Mesdheut nuk ishin sigurisht (po aty, fq. 192) «[...]lexues të etur të tri kurorave» e pra italishtja ishte gati për përdorim

[...] si fushë asnjëse në të cilën luanin me zhdërvjelltësi skuadra shumëgjuhëshe, dhe pothuajse babeliane, të cilat gërshtoheshin nëpër rrugët e lundrimit dhe takoheshin nëpër porte; një gjuhë e cila bashkë me avantazhin e gramatikës të sistemuar shfaqte edhe një qëndrueshmëri të paktën relative [...].

Qëndrueshmëria, ndonëse relative, e italishtes – tipar që rridhte nga përdorimet e saj si mjet letrar – garantonte pikërisht përdorimin praktik në Mesdhe; dhe ky pohim kundërshton traditën historiografike që flet për një italishte “të dënuar” të jetonte kryesisht, ose të kufizohej, vetëm tek elokuencia e pashoqe e artit të Parnasit.

3.1.8. Jo rastësisht, pra, një traditë e tillë do të përqafohej më vonë nga Marina Mbretërore dhe Perandorake Austriake që – Metzeltin¹⁰⁵ e përkufizon si ‘trigjuhëshe’ (gjermanisht, italisht/venecianisht, kroatisht) – e cila e pranoi italishten si gjuhë e komunikimeve detare dhe si gjuhë për t’u mësuar për kuadrot që do të dëshironin të merrnin pjesë.

«Gjuha e mësimit ishte italishtja» – vë në dukje Metzeltin¹⁰⁶ – dhe «kjo na lejon të hamendësojmë se e gjithë trupa e oficerëve duhet të ketë pasur një zotërim të mirë të italishtes shkollore dhe teknike». Vetë admirali Teghetoff, i cili qe student i Marinës Mbretërore dhe Perandorake nga 1840 dhe 1845, ende përdorte shumë italianizma në telegramet që i dërgonte Vjenës gjatë fushatës së 1866; fushatë e cila, pas Lisës, ia ktheu Venedikun Italisë. Anijet e luftës austriake kishin, përpos tjerash, përgjithësisht emra italianë si: Costanza, Danae, Delfino, Fulminante, Galatea, Veneziana, Tremenda, Tartara... sikurse kishin emra italianë (Metzeltin 1992; 328) edhe dy fregatat të cilat ndonjë dhjetëvjeçar më parë – ishte viti 1817 – patën çuar në Brazil arqidukeshën Leopoldina, e bija e perandorit dhe e

103 N. TOMMASEO, *Dizionario estetico*, Firenze 1867, col. 312.

104 BRUNI, *Italiano all'estero e italiano sommerso*, f. 192-193.

105 METZELTIN, *La Dalmazia e l'Istria*, f. 332.

106 Po aty, f. 331.

fejuara e pasardhësit të fronit të Portugalisë, Dom Pedro, njëkohësisht edhe një nga studiuesit e ngarkuar për të eksploruar zonat ende të panjohura të Brazilit.

Italishtja e folur në anije ishte padyshim italishtja krahinore venedikase sikurse Carpinteri-Faraguna¹⁰⁷ dëshmojnë se ishte edhe ajo që fliste arqiduka Francesco Ferdinando:

Dhe ky iu fliste njërit e tjetrit të këtyre ushtarakëve të tij në gjermanisht, kroatisht, italisht, ai dinte gjithçka. Ai ishte trashëgimtari i Lidhjes së Dyfishtë. Vetëm se në italisht ky nuk dinte kurrë të përdorte përemrin “ti”, thoshte gjithmonë [...]: ‘Ju e dini’, kështu, pak simbas së folurës sonë, sikurse e kishte nxënë këtu. ‘Ju e dini se kjo, ju e dini se kjo tjetra’: një mënyrë të të shprehurit.

Nëse gjuha zyrtare e Marinës Mbretërore e Perandorake ishte gjermanishtja, dhe italishtja kishte një rol si gjuhë formimi e kuadrove drejtuese të veprimtarive detare, gjuha që përdorej në bord të anijeve ishte ajo e ekuipazheve: me fjalë të tjera venecianishtja sipas varieteteve: poleziane, triestine, fiumane, lusinjane përveç të atyre të pakicave etnike të pranishme gjatë brigjeve të Dalmacisë. Në jetën në bord ishin të pranishme edhe disa variante të kroatishtes: në fakt, ende në fund të shek. XIX, statuti i kroatishtes si gjuhë detarije ishte i tillë sa – sikurse na thotë Metzeltin¹⁰⁸ – në Vjenë doli në dritë një *Sammlung von Gesprächen in serbo-kroatischer Sprache für den Gebrauch an Bord*, e pasur me shprehje të thjeshta, që mund të mendojmë se iu drejtoheshin rekrutëve ose detarëve të rangut të ulët: shprehje të llojit *Ihre Hängematte ist schlecht geschnürt, sieht äie eine Wurst aus. Vaša je branda lošo svezana, izgleda kao kobasica*. (Hamaku juaj është lidhur keq, duket si sallam.)

Përveç kësaj në Fiume/Rijekë – qendër e detarisë hungareze dhe pikë mbërritjeje e dy hekurudhave, njëra nga Triestja dhe Austria (1871), tjetra nga Hungaria dhe Kroacia (1873), qyteti ku u themelua shoqëria hungaro-kroate (e përbërë kryesisht nga anije të tonazhit të vogël për tregtinë në brigjet e Kroacisë dhe të Dalmacisë) – u hap një akademi detarije dhe më pas u themelua një shkollë detarije, pjesërisht dygjuhëshe (hungarisht dhe gjermanisht). Nuk çudit, pra, fakti se «një përqindje e oficerëve, ndonëse e vogël në numër, ishte hungareze për nga kombësia dhe shumë të rinj, të shtyrë nga shpirti i aventurës, u shkruan në marinë.»¹⁰⁹ dhe kështu që disa elemente të terminologjisë detare hungareze u përshkuan nëpër rrugët e Adriatikut (fjalë si *kormány* “timon”, *vitrola* “velë”, *csónak* “barkë”, etj.) ndonëse – sikurse vë në dukje me të drejtë Santarcangeli¹¹⁰ – nuk gjendet

107 L. CARPINTERI – M. FARAGUNA, *L’Austria era un paese ordinato*, Trieste 1980, f. 226.

108 METZELTIN, *La Dalmazia e l’Istria*, f. 332.

109 SANTARCANGELI, *Una terminologia marinaresca*, f. 481-482.

110 Po aty, f. 486.

«[...] as edhe një fjalë që të ketë kaluar nga hungarishtja në terminologjinë detare të gjuhëve të tjera, përveç ndonjë rasti në kroatishten kajkave.» Ndërkaq, është i dukshëm dhe i një prirjeje të kundërt fakti se në hungarisht u përfshinë fjalë italishte, ose më saktësisht, nga dialekti venedikas, që tregojnë emrat e erërave (*bóra* “bora”, *sirókkó* “shiroku”); për lundrat (*bárka* “barkë”, *gálya* “galé”, etj); emra aparaturash (*kabin* “kabinë”, *lámpa* “lampada”, *bója* “bovë”, szemafor “semafor”, etj., nganjëherë nëpërmjet gjuhëve si kroatishtja (ose gjermanishtja) dhe kjo është e kuptueshme.

4. Panorama gjuhësore në mjedisin sllavo-ballkanik në kuptim e zgjeruar adriatikas shfaqet ndërmjet shekujve XVIII - XIX si e karakterizuar nga disa kushte veçanërisht të ndërlikuara, si rezultat, përpos tjerash edhe nga fragmentarizimi i brendshëm gjuhësor i Sllavërisë, edhe nga orientimi i ndryshëm i komponentëve sllavo-jugorë që ishte pjekur gjatë shekujve.

Mbi çarjen e parë, që u ravijëzua në shekujt e vonë të mesjetës, ndërmjet botës sllavo-ballkanike, e orientuar drejt Kostandinopojës (dhe mjedisit fetaro-institucional greko-bizantin) dhe një bote sllavo-ballkanike e orientuar drejt një krishtërimi romak (dhe mjedisit fetaro-institucional romako-gjermanik) – një e çarë mjaft e dukshme edhe në kundërvënien ndërmjet botës serbe, bullgaro-maqedonase dhe botës slloveno-kroate – ishte shtresëzuar dalngadalë edhe një e çarë tjetër, e cila përfaqësohet, për mjedisin serb dhe bullgaro-maqedonas nga kontaktet me elementin greko-bizantin (dhe pastaj neogrek) dhe me elementin turko-osman; ndërsa për mjedisin slloveno-kroat nga marrëdhëniet gjithnjë e më të dendura me mjedisin ballkano-roman (dalmat, në veçanti) dhe, mbi të gjitha me Venedikun dhe Italinë, por edhe me marrëdhëniet me botën gjermanike (me Austrinë habsburgase) dhe, në veçanti me mjedisin kroat, me botën hungareze.

4.1. Në botën sllavo-jugore – sikurse edhe tjetërkund në Sllavërinë ballkanike, qoftë të ngjyrës kroate, qoftë të ngjyrës serbe – ndryshe nga fragmentarizimi në dialektin çajkav, kajkav dhe shtokav në të cilat ishin shkruar vepra letrare sipas varieteteve të posaçme të mjediseve të veçanta gjuhësore (po kufizohemi këtu vetëm me Dalmacinë: e Splitin, Raguzën, Zarën, Hvarin, në veçanti), gjuha e madhe “çati” përfaqësohej nga një variant gjuhësor mbikrahinor i një tradite të lashtë: sllavishtja kishtare, ose sllavishtja e zakonshme, një varietet ky i futur nga traditat kishtare dhe që përdorej ende gjerësisht për qëllime joliturgjike deri në gjysmën e shek. XIX, prap me variante kuptimplote vendore (kroate, serbe, boshnjake)¹¹¹.

Prania në Venedik e individëve të ‘schiavonesco’-s, d.m.th. të sllavishtes së folur – ose të folurës jo të përsosur (sepse këtu ndërhyjnë edhe individë

111 M. KAČIĆ, *Le croate et le serbe. Illusione et falsifications*, Paris, 2000, f. 11-12.

sllavë të popullit) në të folurën veneciane të ‘skiavonëve’, që kishin emigruar në qytetin e doxhëve për arsye punësimi, tregtie ose milicie – është e dëshmuar, duke filluar nga pesëqindëshi, në të ashtuquajturën letërsi “schiavonesca” gjurmët zbavitëse të së cilës i gjejmë te lënda botuar nga Cortelazzo¹¹², jo e ndryshme nga ‘letërsia stratiote’ venediko-neogreke, prandaj po sygjerohet edhe njëherë Cortelazzo-n¹¹³. Për më tepër, letërsia në gjuhën sllave ishte ende në kulmin e vet në shtatëqindëshin, nëse është e vërtetë – siç na thotë Cortelazzo¹¹⁴ – se Angelo Maria Barbaro ende zbavitet duke kompozuar *montenegrinada*, të afërta me shijet e parodisë së letërsisë pararendëse.

Duhet kujtuar këtu se përdorimi i fjalëve popullore sllave në kuadrin e letërsisë nuk kishte munguar as në shekujt pararendës: në shek. XVI, krahas veprave latinisht nga ana e latinistëve (dalmatë, serbë, kroatë), u pat shfaqur edhe një letërsi në kroatisht (në poezi, Marko Marulić kishte botuar në Venedik në 1501 poemën “Judita”; raguzanët Petar Menčetić, Marin Krstičević, Džore Držić kishin thurur vjersha me ritme të Petrarkës, duke marrë frymëzim nga letërsia popullore dhe fetare). Faust Vrančić te vepra e tij “*Dictionarium quinque nobilissimarum Europae linguarum Latinae, Italicae, Germanicae, Dalmaticae et Ungaricae*”, dalë në dritë në 1595, e kishte renditur, për më tepër, variantin sllav të Dalmacisë ndër gjuhët më të rëndësishme të Evropës dhe në 1622, Bartul Kašić, kishte përcaktuar variantin shtokav si bazë për formimin e një gjuhe të përbashkët sllave.

Në periudhën e kundërreformës, rëndësia e politikës gjuhësore që i

112 Bëhet fjalë për një rrymë letrare që pati jetë të shkurtër në pesëqindëshin venedikas dhe që kishte në qendër, si protagonist stereotipin e sllavit të shpërngulur në Venedik, dhe që përdorte dialektin e tij të përzier me huazime të kushtëzuara nga zakonet e veta gjuhësore. Po e marr këtë, komenton CORTELAZZO, në *La stampa popolare in schiavonesco*, nga *Il libro nel bacino adriatico (shek. XV-XVIII)*, nën përkujdesin e S. GRACIOTTI, Firenze 1992, f. 155, «[...] gjë që e bënte të tingëllonte qesharak dhe zbavitës». Përhapësit, nëmos shpikësit e kësaj gjuhe, qenë tre gaztorë të rrugës, emrat e të cilëve njihen: Domenico Taiacalze (vdekur në 1513), Zuan Paolo (ose simbas sllavishtes, Ivan Pavlavichio da Ragusi, vdekur në 1540) dhe biri i tij, Gerolamo, i njohur gjerësisht si ‘el fio de Zuanpolo’ – i biri i Gjon Palit. M. Sanudo, *Diarii*, vëll. 58, Venezia, 1879-1903 na kujton me përpikmërinë e kronistit të aftë mënyrën si recitonte i famshmi Zuan Polo dhe biri i tij Gerolamo (*po aty*, LVIII: 542): «Da poi venuto zoso al Consejo, avendo Zuan Polo piacevole bufon preparato un soler appresso al Relogio, vestito da poeta con zola de lauro in testa, suo fiol ed un altro travestidi, è un sermon a tuti et dete fuora l’opera composta per lui a stampa di Rado Stizoso [...]» (*Rado Stizoso është titulli i një komedie ‘schiavonesca’*). Gjuha dhe përmbajtja e këtyre veprave letrare ishin, në mënyrë të kuptueshme, ‘të ulta’, siç del nga vargjet e një kënge ‘schiavonesca’ që sjell CORTELAZZO, *po aty*, f. 158: *Taritrùn chacho in bun / tutta note andirò zinte / per so manzi e bin voiente / che vignissigna a alcun / taritrùn taritrùn / cacho dobro salsizun*.

113 Po aty, f. 125-172.

114 M. CORTELAZZO, *Gli slavismi nel Veneto*, tek «Est-Europa», 1, (1984), f. 67.

kushtonte kujdes nevojave të popullit për të kuptuar, ishte pritur mirë nga dy mbrojtës të katolicizmit: françeskanët Filip Grabovac dhe Andrija Kačić-Miošić, që ishin përkras të përhapjes së variantit shtokav. Veçanërisht Andrija Kačić-Miošić e kishte thyer dukshëm konceptin e një vizioni provincial të gjuhës dhe – duke përdorur njëmbëdhjetëroreshin serb, duke iu drejtuar të gjithë atyre që mund ta kuptonin gjuhën e tij, për herë të parë, pa dallim klase, besimit fetar apo rremb familjeje – dhe pati kënduar kështu lavditë e të gjithë princave sllavë jugorë. Mbi këto themele u bazuan Dositej Obradović (1724-1811) dhe Vuk Stefanović Karadžić (1787-1864). I pari që një intelektual turbullues i cili u solli serbëve një kozmopolitizëm përparimtar dhe u përpoq ta lehtësonte gjuhën letrare duke e larguar nga streha e gjuhës sllave kishtare për ta afruar me atë popullore; i dyti i dha kulturës së popullit të vet një orientim të ri, duke reformuar gjuhën, duke përcaktuar drejtshkrimin, duke hartuar një fjalor dhe duke mbledhur këngë folklorike të suksesshme.

4.2. Në mjedisin kroat po përgatitej, në përputhje me idetë romantike të pjesës së parë të tetëqindëshit¹¹⁵, terreni i përshtatshëm për formimin e Lëvizjes ilirike (*Ilirski preporod*), i cili, promovuar nga Ljudevit Gaj, u tregua krejtësisht kundër hegjemonisë hungareze dhe asaj serbe: nga këndvështrimi gjuhësor, kjo lëvizje donte ta bënte shtokavishten, në variantin e saj neo-shtokavo-ijekav i cili përdorej nga shkrimtarët raguzanë, bazë të një koinjëje letrare që do t'iu jepte kroatëve një bashkim gjuhësor dhe kombëtar¹¹⁶.

115 Kjo ndodhi me Bonapartin. Mbasi i mundi Habsburgët në Ēagram, Napoleone imponoi paqën e tij (tetor 1809). Austria i lëshoi sundimet e saj të fundit në Dalmaci, krahas Triestes edhe Karniolën, Karincien dhe një pjesë të mbretërisë së Kroacisë. Të gjitha këto teritore formuan 'Provincat ilirike' (1809-1813), që u aneksuan drejtpërsëdrejti nga perandoria franceze. Gjithashtu edhe Ragusa u aneksua. Mbasi u pushtua nga Bonaparti në 1806, qyteti iu nënshtrua sundimit francez sipas një dekreti në fuqi të vitit 1808, nëpërmjet një proklamate që thoshte se «la république de Raguse avait cessée d'exister». Por në 1815 Austria do ta shtinte prap në dorë gjithë bregdetin e Dalmacisë deri në Kotorr dhe ishujt jonikë kaluan nën protektoratin e Britanisë së Madhe. Krhs. CASTELLAN, *Histoire des Balkans*, f. 228-229.

116 R. GREENBERG, *Language and identity in the Balkans. Serbo-Croatian and its Disintegration*, Oxford 2004, f. 109 nënvizon faktin se të zgjedhurit e një varianti neo-shtokav/ijekav si bazë e gjuhës kombëtare kroate nuk që krejtësisht e kollajtë, meqë për shekuj me radhë, para 1830, dialekte të tjera të ndryshme kishin fituar prestigj në mjedisin kroat dhe zona të ndryshme të Kroacisë kishin zhvilluar prej një kohe të gjatë tashmë një identitet të tyre kulturor dhe gjuhësor, posaçërisht në Istrië, në Dalmaci dhe në Sllavoni. Mbasi u mund Bonaparti dhe mbas bashkimit të tokave kroate nën sundimin austro-hungarez u ashpërsuan përplasjet ndërmjet prirjeve territoriale dhe përpjekjeve për centralizim dhe pikërisht në këtë fazë, lëvizja ilirike u përpoq të bashkonte popullin kroat nëpërmjet përhapjes së një modeli gjuhësor bashkues.

4.3. Në këtë kuadër, në të cilin mbisundon Vjena perandorake, duhen konsideruar si elemente të mëtejshme në këtë fushë marrëdhëniet ndërmjet kroatëve dhe hungarezëve. Të kihet parasysh se Kroacia për shumë shekuj pati qenë tokë e kurorës së Shën Stefanit. Duke filluar nga Shën Ladislavi (László), mbreti i Hungarisë nga 1077 deri në 1095 dhe pushtues i Kroacisë. Pastaj nga viti 1102, kur mbreti hungarez Koloman Libërdashësi (Hu. *Könyves Kálmán*) u bë sovran i Hungarisë. Që nga ai vit e deri në 1918 tokat kroate mbetën të lidhura ngushtë me ngjarjet hungareze deri, domethënë, në çastin kur Austria mbaroi. Marrëdhëniet kroato-hungareze qenë përgjatë shekujve përgjithësisht jo tepër konfliktuale¹¹⁷ dhe kjo gjendje vijoi deri në çastin kur, me pushtimin bonapartian të provincave ilirike, u vunë re pasojat ideologjike të Revolucionit Francez. Nga këndvështrimi i politikave gjuhësore, në një front kundër Vjenës, Kroacia dhe Hungaria luftuan së bashku kundër ndërhyrjes së gjermanit (sipas asaj që kishte menduar Jozefi II)¹¹⁸ në çështjet e tyre publike, dhe – diçka tepër domethënëse –

117 Përveç disa konflikteve në shek. XIII dhe deri në 1526 kur osmanët eliminuan Luigjin II Jagelon dhe i hapën rrugën hegjemonisë së gjatë të Habsburgëve. Cilësia e marrëdhënieve të mira ndërmjet hungarezëve dhe kroatëve simbolizohet nga figura të rëndësishme letrare të përbashkëta për të dyja këto hapsira kulturore.

G. MANZELLI, *Dal continuum slavo meridionale al bosniaco: il destino della lingua serbocroata nella dissoluzione della lugoslavia*, në *Percorsi socio- e storico-linguistici nel Mediterraneo*, me përkujdesin e E. BANFI, Trento 1999, f. 167-168) sjell rastin tepër të famshëm të poetit të madh humanist János Cseszmicei (Ivan Češmički, për kroatët), i njohur me emrin latin Janus Pannonius (1434-1472), me origjinë nga Osijek (Eszék në hungarisht; Esseg, në gjermanisht) të cilit i ra në hise të vdiste në Medvedgrad (Medvevár, në hungarisht), në veri të Zagrebit, mbasi kishte kaluar dymbëdhjetë vjet në Itali (sa në Ferrarë e në Padovë), dhe pjesën tjetër si ipeshkëv i Pécs. I tillë është prap edhe rasti i familjes Zrínyi (Zrinski ose Zrinjski, për kroatët), nga e cila dy vetë – Miklós (1620-1664) dhe Petar (1621-1671) – qenë nderi i letërsisë, qoftë hungareze, qoftë kroate, duke qenë se këta ishin dygjuhësh dhe me dy kombësi në një kohë kur fisnikët hungarezë dhe kroatë kishin vetëm një atdhe *regnum Hungariae*. Rreth marrëdhënieve hungaro-kroate (duke i kushtuar vëmendje edhe rolit të hungarishtes përgjatë bregut të Adriatikut dhe në mjedisin kroat) na jep të dhëna të pasura edhe G. SCHUBERT, *Ungarische Einflüsse in der Terminologie des öffentlichen Lebens der Nachbarsprachen*, Berlin 1982, f. 101-121.

118 E që të themi të vërtetën, edhe më parë, nga perandoresha Maria Tereza. krhs. MAITZ, *Sozialpsychologie des Sprachverhaltens*, f. 81: «In die Sprachlichkeit Ungars äird mit Hilfe der Gesetzgebung das erste Mai 1777, mit der Ratio Educationis der Kaiserin Maria Theresia tiefer eingegriffen. Die Kaiserin bemüht sich – im Sinne des neu aufkommenden (Sprach)nationalismus – stets um die Stärkung der Dominanz des Deutschen, so äie es dann später auch ihr Sohn und Nachfolger, Joseph II. tut. Von explizitem Sprachzëang kann allerdings erst bei letzterem die Rede sein. Joseph II. ist es, der mit seinem Sprachedikt aus dem Jahre 1784 das Deutsche zunächst neben, später aber statt Latein als offizielle Amtsprache des Reichs, somit auch Ungarns, einführt. Es ist auch, der mit Punkt 7 dieses Edikts verordnet, dass niemand in mittlere Schulen aufgenommen äerden dürfe, ohne auf Deutsch lesen und schreiben zu können». Rreth këtyre çështjeve, krhs. edhe G. MANZELLI, *Dal continuum slavo*

parlamentet e tyre përkatëse (*Országgyűlés* hungarez – Asambleja e vendit, që zakonisht përkthehet si ‘Dieta hungareze’, dhe *Sabor*-i kroat) kishin të dy latinishten si gjuhë zyrtare. Kjo gjendje vijoi deri të paktën në 1843 dhe në Kroaci, dhe deri në 1844 në Hungari¹¹⁹.

Po ashtu mos të harrohet se në vitin 1791, pak vite pas regjistrimit të popullsisë kërkuar nga Jozefi II në 1785, u miratua ligji i parë gjuhësor hungarez, mbas së cilit erdhën edhe të tjerë, të gjithë me një qëllim: përhapjen e hungarishtes edhe në zona ku nuk kishte hungarishtfolës. Ligjet e mbretërisë hungarezo-kroate u kodifikuan dhe u redaktuan në hungarisht dhe në latinisht. Hungarishtja u imponua si gjuhë e detyrueshme e arsimit, po kështu u imponua edhe për korrespondencën zyrtare. Nëpunësit e administratës publike që nuk do të përdornin hungarishten do të pushoheshin nga puna, dhe, duke filluar nga 1827, *Országgyűlés*-i hungarez ia imponoi përfundimisht *Sabor*-it kroat përdorimin e hungarishtes¹²⁰.

Reagimi i kroatëve që i kuptueshëm, sepse këta panë se do t’iu kufizohej ndjeshëm autonomia nga ligjet jozefine. Që këndej doli edhe propozimi që të futej kroatishtja si gjuhë zyrtare e shtetit dhe u forcuan idetë ‘iliriste’ të Ljudevit Gaj-it¹²¹. Marrëdhëniet ndërmjet Kroacisë dhe Hungarisë u përkeqësuan pastaj në mënyrë të pandreqshme në 1848 kur gjenerali (dhe pastaj bani i Kroacisë) Josip Jelačić iu kundërvu Lajos Kosuth, duke kontribuar kështu në dështimin e revolucionit hungarez. Por ndërmjet kroatëve dhe hungarezëve gjendej Vjena, e cila pas luftës të pasuksesshme që zhvilloi Franc Jozefi kundër Prusisë në 1866, u shtrëngua t’i bënte koncensione të gjera hungarezëve me ‘Kompromisin’ (*Ausgleich*) e vitit 1867, si pasojë e të cilit, kroatët u poshtëruan akoma më shumë dhe iu nënshtruan vendimeve të Pestit (më vonë Budapest). Për rreth pesëdhjetë

meridionale al bosniaco, f. 166-170.

119 MAITZ, *Sozialpsychologie des Sprachverhaltens*, f. 82: i përket vitit 1844 një ligj i administratës perandorake që «[...] die uneingeschränkte Einführung der ungarischen Sprache als Amtssprache Ungars verordnet. Somit kann das Ungarische nach längerer Zeit eieder die formellen, offiziellen Domänen der Kommunikation erobern, die Domänen der Gesetzgebung, der Verëaltung, der Justiz und des Unterrichts besetzen; Domänen also, die früher entëeder vom Latin oder – später – vom Deutschen besetzt ëaren. Somit ëird das Ungarische etëa auch als allgemeine und obligatorische Unterrichtssprache eingeführt». Pas shtypjes së revolucionit hungarez (1848/1849) gjërat ndryshuan përsëri: u anulua kushtetuta hungareze dhe, në atmosferën e absolutizmit perandorak, (*po aty*, f. 82) «Als offizielle Sprache der staatlichen Verëaltung gilt ëieder das Deutsche und es löst das Ungarische auch in der Domäne des gymnasyalen Unterrichts ab».

120 SCHUBERT, *Ungarische Einflüsse in der Terminologie*, f. 118-119.

121 *Po aty*, f. 120: «Der Illyrismus Gajs verband mit kultureller Erneuerungsarbeit konkrete politische Ziele: zunächst die Schaffung eines selbständigen kroatischen Staates innerhalb Ungarns, ab Mitte der 40er Jahre die Errichtung eines grossen südsläëischen Staates».

vjet, gjatë epokës së Austro-Hungarisë (1867-1918), qeveritë nacionaliste hungareze i përkeqësuan edhe më tej marrëdhëniet kroato-hungareze (por jo vetëm këto, por edhe ato me sllovakët, sllovenët, serbët dhe rumunët etj.) kështu që shumë shkolla kroate u mbyllën duke iu dhënë përparësi shkollave në gjuhë hungareze në zona ku nuk ishin të nevojshme nga pikëpamja etnogjuhësore dhe shumë kroatë u detyruan të hungarizojnë mbiemrat e tyre. Për më tepër, *Horvát* ose *Horváth* është një nga mbiemrat më të përhapur në Hungari.

Një tregues i atmosferës së marrëdhënieve kroato-hungareze është historia e Fiumes/Rijekës, qytet që iu pat dhënë nga Mari Tereza në 1769 si dhuratë e hijshme, popullit hungarez, qytet i cili u aneksua pastaj nga Hungaria në 1776 dhe mbeti i tillë deri në 1779 kur mori statutin e *corpus separatum* të kurorës hungareze. Pasi u maxharizua thellësisht në vitet e fundit të Austro-Hungarisë, Fiume/Rijeka u shndërrua në një shesh marrëdhëniesh jo të kollajta ndërmjet hungarezëve dhe kroatëve. Qenë më pak konfliktuale marrëdhëniet ndërmjet kroatëve dhe italianëve.

4.4. Në një klimë gjuhësore thellësisht të paqëndrueshme, në të cilën vepronin si gjuhë prestigji gjermanishtja, latinishtja, italishtja letrare dhe hungarishtja, nuk duhet të çuditemi nëse në Dalmacinë adriatikase njerëzit e kulturës, në mes të shek. XIX, turpëroheshin të flisnin në cilindo variant të kroatishtes. Dëshmi të kësaj gjendjeje ekzistojnë te një letër që Tommaseo i dërgon Steiglitz-it në vitin 1842 në të cilën, duke krahasuar gjendjen gjuhësore në Dalmacinë e asaj kohe, një vend i hapur drejt zbulimit romantik të rrënjëve të veta, me ato të kohëve të fundit, ky vinte në dukje¹²²:

Njerëz letrash dhe gra, që njëherë e një kohë do të ishin skuqur po t'iu kishte pëlqyer tingëllimi i gjuhës sllave, në Kroaci ka. Nga ky turp do të lipsej që të gjithë njerëzit e ditur të Dalmacisë të laheshin, dhe duke ndjekur shembullin e zonjave raguzane, dhe madje akoma më pastërtisht se këto, ilirishtja [kupto: sllavishtja] të përdorej gjithmonë në bisedat familjare.

Ilirizmi i Ljudevit Gaj-it, u kundërshtua rreptësisht nga intelektualët serbë, kundërshtarë të bashkimit të të gjithë sllavëve jugorë, me frikën se kjo lëvizje do të përfshinte edhe elementë perëndimorë¹²³. Në dialektikën ndërmjet intelektualëve serbë dhe kroatë u shfaq përsëri kundërvënja shekullore ndërmjet dy hegjemonive brenda botës sllave jugore (kroate dhe serbe) pasojat e së cilës mbërritën tragjikisht edhe në ditët tona, duke

122 N. TOMMASEO, *Scritti editi ed inediti sulla Dalmazia e sui popoli slavi*, Firenze 1943, f. 115.

123 M. KAČIĆ, *Le croate et le serbe. Illusions et falsifications*, Paris 2000, f. 37; GREENBERG, *Language and Identity*, f. 111.

u mishëruar në dramën e luftimeve ballkanike të dhjetëvjeçarit të fundit të shek. XX që porsa kaloi.

4.5. Duhet shqyrtuar veçmas gjendja gjuhësore në Bosnjë. Në këtë zonë, krejtësisht të përfshirë në orbitën osmane në fazën e tranzicionit ndërmjet shek. XVIII - XIX, emancipimi kombëtar i së cilës mbeti në hije në krahasim me atë të serbëve dhe të kroatëve, elitat vendore¹²⁴, përdornin pothuajse krejtësisht përveç turqishtes, gjuhë e sundimarëve osmanë, edhe dy gjuhët e mëdha të kulturës së mjedisit turko-osman: arabishten dhe persishten. Në variantin sllavo-boshnjak, që zakonisht përdorej si mjet komunikimi i përditshëm brenda mjedisit boshnjak, gjeti shprehje edhe një letërsi popullore, me një peshë të kufizuar dhe me qarkullim disi modest, e shkruar me alfabet arab të kodifikuar.

5. Në tranzicionin ndërmjet shekujve XVIII - XIX gjendja gjuhësore në Shqipëri pasqyrore pikën e mbërritjes së një udhëtimi historik krejtësisht të veçantë. Nën ndikimin politik dhe fetar, qoftë greko-bizantin (në Toskëri dhe në pjesën jugore të territorit shqiptar) qoftë në atë romano-katolike (në Gegëri, në zonën veriore të territorit të saj) dhe pastaj që u islamizua vrullshëm (nga shek. XV dhe mbi të gjitha pas 1690, me konvertimet e dhunshme të shqiptarëve katolikë të ashtuquajturit 'dömnë' të cilët kishin mbështetur Lidhjen e Shenjtë.¹²⁵) në periudhën e tranzicionit ndërmjet shek. XVIII - XIX, Shqipëria shfaqej si një vend i ndarë në principata të vogla autonome nënshtruar sundimitarëve osmanë. Ternon¹²⁶ na kujton me të drejtë se «[...] un double clivage religieux et ethnique sépare les Albanais: le sud est orthodoxe, le centre musulman, le nord catholique».

Toka e mbasardhësve të Skënderbeut gjendej në një pikë takimi të ndikimeve të ndryshme dhe të rëndësishme. Mjedisi shqiptar i lidhur me besimin fetar ortodoks shihte drejt kulturës greke, drejt botës greko-kostandinopojase dhe natyrisht, drejt gjuhës greke; mjedisi shqiptar i drejtuar nga perëndimi romano-katolik kishte tri pika të mëdha referimi – Venedikun, Romën dhe qytetet e Dalmacisë së venecianizuar – dhe, si pasojë, e ndjente si *continuum*-in gjuhësor që rrezatonte Venediku, ashtu edhe ndikimin e katolicizmit romak, edhe nëpërmjet ndërmjetësisë dalmate.

124 Bosnja, kjo provincë kufitare e Perandorisë Osmane, gëzoi një periudhë të gjatë mirëqenieje të përgjithshme dhe zhvillimi. Boshnjakë të shumtë luajtën një rol të dukshëm në jetën politiko-shoqërore të Perandorisë Osmane. Numerosi bosniaci ebbero un ruolo notevole nella vita politico-culturale dell'Impero ottomano occupando posizioni di rilievo nella burocrazia e nell'esercito.

125 TERNON, *Empire ottoman*, f. 90-91 i përshkruan *dömnë*, ose shqiptarët e krishterë të kthyer në islam si myslimanë krejtësisht atipikë sepse shpeshherë i ruanin «leurs coutumes chrétiennes» – zakonet e tyre të krishtera.

126 Po aty, f. 91.

Në nivel popullor, prapseprap, nuk duhet anashkaluar edhe ndikimi i ushtruar në të folmet shqiptare nga dialektet italo-jugore, që fliten në zonën e poshtme të Adriatikut, mbi të gjitha nga dialektet e Puljes dhe të Salentit. Mbi këtë realitet ishte shtresëzuar pastaj, në të gjithë Arbërinë në mënyrë kapilare, duke filluar nga shek. XV dhe deri në agimin e shek. XX, prania turko-osmane, e cila, duke e orientuar këtë skaj të Ballkanit drejt Bosforit, tashmë krejtësisht turk dhe jo më drejt atij krejtësisht grek, i kishte shndërruar territoret arbërore në vendet ku penetrimi i elementit turk ishte më i madhi në Evropë.

5.1. Shpirti i pavarësisë i cili mbushi plot të gjithë zonën e Ballkanit në periudhën e tranzicionit ndërmjet shek. XVIII - XIX preku edhe territorin greko-shqiptar. Kryengritjet kundër Portës së Lartë qenë të shumta. Më e rëndësishmja nga këto mbetet padyshim ajo e Ali pashë Tepelenës (1741-1822) i cili, fillimisht i mbështetur nga francezët dhe pastaj nga anglezët, ia doli në fakt, ndonëse për një periudhë të shkurtër, të bëhej i pavarur nga 1820 deri në 1822. Ali pashai, rreth të cilit gjykimet kanë qenë (dhe janë) kundërshtuese¹²⁷, është personazhi i një poeme epike (Ἀλπισιάδα) me rreth dhjetë mijë vargje, të shkruara në greqishten e re nga Chatzi Sechretis. Autori ishte, si të themi, një nga panegjristët e oborrit të pashait dhe poema epike nuk është gjë tjetër veçse një lloj 'autobiografie' e këtij protagonistit¹²⁸.

5.2. Nga këndvështrimi gjuhësor, Shqipëria, ende pa një gjuhë kombëtare në fazën e tranzicionit ndërmjet shekujve XVIII - XIX, karakterizohej nga një gjendje shoqërore-gjuhësore tepër e ndërlikuar. Nëse komunikimi i përditshëm kryhej natyrisht sipas segmenteve të *continuum*-it dialektor toskë dhe gegë, të orientuar, i pari drejt ambientit grek, i dyti drejt ambientit roman dalmato-jugor dhe sllavo-jugor (dhe të dy këta, sidoqoftë, të pasur me elemente të turqishtes së folur) elitat shqiptare, në mënyra të ndryshme, sipas vendit të tyre brenda bashkësisë së cilës i përkisnin, kishin si gjuhë kulture (në kuptimin e vërtetë të fjalës 'gjuhë çati') ose

127 M. KAPPLER, *Turcismi nell'Alipasiadha di Chatzi Sechretis*, Venezia 1993, f. 6-8. Dëshmitë e bashkëkohësve nuk na përcjellin një imazh shumë pozitiv të tijin. Atributet që i mvisheshin më shpesh Ali Tepelenës ishin 'tirani', 'satrapi mizor i Janinës', 'Falarisi i ri i Epirit'. Menjëherë pas vdekjes së tij të dhunshme (ia patën prerë kokën më 24 janar 1822 ushtarët e Hurshit pashait në manastirin e Pantelejmonës, në ishullin në liqenin e Janinës, ku ishte strehuar me gruan e re greke, Vasilikinë) u bë personazhi kryesor i shumë veprave letrare folklorike, si në greqishten e re ashtu edhe në shqip.

128 Po aty, f. 8. Dihet se shpeshherë 'Aliu me gjasë krejtësisht injorant, por sidoqoftë njohës i tri gjuhëve të folura në mbretërinë e tij (turqishtes-osmane, greqishtes së re, dhe shqipes), i kërkonte vetë autorit Chatzi Sechretis që t'ia recitonte poemën, duke e detyruar që aty-këtu t'i shtonte hollësi që i kishin shpëtuar vëmendjes së poetit.

turqishten osmane (së cilës i shtoheshin fatalisht edhe arabishtja dhe persishtja), ose greqishten e re, ose italishten letrare, ose për më të diturit, edhe latinishtja¹²⁹. Gjuha zyrtare e mbretërisë së Ali Tepelenës ishte, fjala vjen, turqishtja osmane, gjuhë e oborrit dhe nëpërmjet së cilës veziri komunikonte me nëpunësit e tij. Por vetë 'Ali Tepelena fliste po aq mirë edhe greqishten të cilën e përdorte edhe në të shkruar «[...] domethënë për *buyurdī*, me fjalë të tjera, urdhërat të cilat, kur duhej të lexoheshin në mënyrë publike në disa zona, nganjëherë ishin të shkruara deri edhe në gjuhën shqipe.»¹³⁰.

Nuk çudit aspak fakti që jehona dhe forma të Lindjes vihen re edhe në vjershërimet e poetëve myslimanë shqiptarë të shek. XVIII si Muhamet Çami, Zyko Kamberi dhe mbi të gjithë Nezim Frakulla, ky i fundit, autor i një *Divani* që përmbledh disa lirika, krejtësisht të pavaruara për nga idetë, diçka krejt e pazakontë në atë periudhë fanatizmi obskurantist. Nuk çudit prap, as fakti se mjedisit grek i ishin drejtuar Teodor Kavaljoti (1728-1789) dhe Mjeshtër Danieli (1754-1811), dhe se përkundrazi nga kultura italiane shihte ajo pjesë e bashkësisë shqiptare që kishte si pikë referimi në Shkodër praninë e fortë katolike të ndriçuar nga Venediku dhe Roma. Kjo e fundit ishte arena e veprimtarisë së ipeshkvijve katolikë të cilëve, ndërmjet shek. XVII - XVIII kishin botuar vepra në gjuhën shqipe: Pjetër Budi (1566-1623), Frang Bardhi (1606-1643), Pjetër Bogdani (1630-1689). Këtij të fundit i përket vepra monumentale «Çeta e Profetëve», shkruar shqip dhe italisht, dhe që pa dritën e botimit në Padovë në 1685. Kjo është dëshmia e parë e përdorimit letrar të shqipes.

6. Territori romeik, në prag të Ἐπανάστασις kundër turqve – përjashto këtu territoret heptanezanike ku sundonte Serenissima ('Fort e Kthjellta Republikë') deri në 1797, karakterizohej, sikundër edhe pjesa më e madhe e territorit ballkanik, nga prania e një mozaiku të jashtëzakonshëm popullatash, feshë dhe gjuhësh¹³¹: grekët (ροῦμιοί), që për më tepër, përbënin edhe shumicën brenda kufijve të Πουμελία, kishin një hapësirë gjeografike relativisht të kufizuar që e ndanin, përveçse me turqit (të pranishëm pothuajse kudo, përveçse në disa zona anësore, si për shembull në disa pika të Thesalisë dhe të Peloponezitet), edhe me sllavët jugorë (të ngulur në territoret e Greqisë Veriore: në Epir, Maqedoni, Traki), dhe me shqiptarët (të shpërndarë nëpër Epir dhe në Atikë). E ndanin edhe me

129 Po aty, f. 2-4.

130 Po aty, f. 4.

131 E. BANFI, 'Ta taliànika' di un poliziotto eptanesio in una commedia neogreca del 1836, në *La 'lingua d'Italia'. Usi pubblici e istituzionali*. Atti del XXIX Congresso internazionale di Studi della Società di Linguistica Italiana (Malta, 2-5 novembre 1995), me përkujdesjen e G. ALFIERI - FIERASSOLA, Roma 1998, f. 398.

hebrenjtë sefarditë (të ngulur mbi të gjitha në Selanik dhe në Vollos), me vllahët (arumunë dhe meglenorumunë, të ngulur njolla-njolla nëpër Epir, Thesali dhe Maqedoni), dhe në fund e ndanin këtë territor edhe me grupet e bëshme të armenëve dhe të Φράγκοι (perëndimorë, përgjithësisht).

Në tranzicionin ndërmjet shek. XVIII - XIX në mjedisin romeik (neogrek), në atmosferën kur përgatiteshin *Επανάστασις* dhe *Ustanak*-u i serbëve, të dy këta popuj të përfshirë në luftën kundër turqve osmanë, ishin mbrujtur me tharme të fuqishme¹³²: dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XVIII, shënuan në veçanti, formimin e një elite romeike të ndjeshme kundrejt atmosferës së iluminizmit evropian dhe sinjaleve të ripërtëritjes politiko-kulturore me të cilën ishin lidhur. Në Greqi, falë edhe kontributit të παποκίης të grekëve jashtështetit (në Itali, Austri, Gjermani, Francë, principatat Danubiane), ishte zhvilluar një lloj iluminizmi neohelenik origjinal (Διαφωτισμός) që vështronte politikisht nga Franca revolucionare, dhe pastaj nga Italia bonapartiste dhe para-romantike¹³³.

6.1. Nga këndvështrimi gjuhësor – prap, edhe njëherë, me shikimin drejt Italisë në lidhje me ‘Questione della lingua’ dhe drejt përvojave evropiane të përparuara në fushën e politikave gjuhësore (Franca, Gjermania, Anglia, Holanda) – në Greqi u ngrit problemi i përkufizimit të një gjuhe, e cila, shartuar në traditën e gjatë dhe fisnike të diakronisë së greqishtes, të ishte një mjet i gjallë¹³⁴ komunikimi jo vetëm për botën etnikisht të larmishme romeike, por edhe më gjerësisht, për atë pjesë të zonës ballkanike që në një mënyrë ose në një tjetër hynte në sferën e ndikimit të traditës greko-ortodokse.

132 CASTELLAN, *Histoire des Balkans*, f. 258-262.

133 Rreth ndikimit të mendimit iluminist të Evropës Qendrore në formimin e A. Korais (1748-1833), përfaqësues i së lartës Διαφωτισμός neogreke, duke u ndalur veçanërisht te problemet gjuhësore së Greqisë në prag të pavarësisë kombëtare, krhs. V. ROTOLO, *A. Korais e la Questione della lingua in Grecia*, Palermo 1965.

134 Në lidhje me politikën gjuhësore të Greqisë së re dhe më në veçanti, në lidhje me nevojën e përdorimit të një gjuhe të gjallë, të afërt me përdorimin e ‘vërtetë’, atë të popullit, por ama jo në konflikt përsa i përket trashëgimisë dhe traditës u shpreh, në mënyrë mjaft të drejtpeshuar, edhe TOMMASEO, *Il supplizio di un italiano*, f. 186: « Noi vogliamo che il greco d’oggi debba ormai in tutto distaccarsi dal vecchio e sdegnarlo. Le due lingue, anco adulte, possono nutrirsi tuttavia del latte materno. [...] Mentre le altre lingue tutte attingono dal greco antico i vocaboli della religione, della scienza, dell’arte, i Greci d’oggi [non devono] diseredarsi della ricchezza degli avi. [...] E tante voci che paiono morte, bene cercando, rinverberarsi ancor sonanti nelle bocche del popolo in qualche giogo di monte, o seno di valle. [...] Que’ pedanti che vilipendono il parlare de’ volghi, son come il gallo che razzola nel letame, e della perla non sa che si fare. Cercate l’antico nel moderno e il moderno nell’antico, e sarete men leggeri, o novatori; sarete, o retori, meno burbanzosi; sarete meno ostinati, o politicanti del vecchio; sarete meno avventati, o politicanti del nuovo».

Na dëshmon për këtë edhe prologu i të famshmit Τετράγλωσσον Λεξικόν, që doli në dritë në 1802, ku autori, arumuni i ditur Daniel Moskhopolites (1754-1825), lindur dhe veprues në Moskhopolis, i ftonte të gjithë elementët e ndryshëm gjuhësorë të pranishëm në Rumeli (shqiptarët, vllehët, bullgarët dhe të tjerët të njohur përgjithësisht me emrin ἀλλόγλωσσοι që të përqafonin rolin udhëheqës së mjedisit romeik¹³⁵, dhe të bëheshin ρωμαῖοι dhe përkundrazi, ta konsideronin greqishten e re si gjuhë udhëheqëse, nënë të dijes, duke i braktisur gjuhët e folura barbare të tyre:

Ἀλβανοί, Βλάχοι, Βούλγαροι, ἀλλόγλωσσοι χαρῆτε
κι' ἔτοιμασθῆτε ὅλοι σας Ρωμαῖοι νὰ γενῆτε
βαρβαρικὴν ἀφήνοντας γλῶσσαν, φωνὴν καὶ ἥθη...
Γένη σας νὰ τιμῆσετε ὁμοῦ καὶ τὰς πατρίδας
τὰς Ἀλβανοβουλγαρικὰς κάμνοντας Ἑλληνίδας.
Δὲν εἶναι πλέον δύσκολον νὰ μάθετε ρωμαῖκα
καὶ νὰ μὴ βαρβαρίζετε μὲ λέξεις πέντε δέκα.
Λαοὶ οἱ πρὶν ἀλλόγλωσσοι ἀλλ' εὐσεβεῖς τὰ θεῖα,
ξυπνήσατε ἀπ' τὸν βαθὺν ὕπνον τῆς ἀμαθείας,
ρωμαῖκα γλῶσσα μάθετε, μητέρα τῆς σοφίας.

Shqiptarë, vllehë, bullgarë, njerëz gjuhësh të ndryshme, gëzohuni
dhe përgatituni të bëheni Romaioi
duke e braktisur gjuhën barbare, shqiptimin, zakonet...
nderoni brezat tuaj dhe atdhetë tuaj
duke i bërë greke gratë shqiptaro-bullgare.
Më nuk është e vështirë të mësohet greqishtja e re
dhe mos të llafosni barbarishte pesëmbëdhjetë fjalësh.
Popuj që më parë folës së gjuhëve të tjera, por ama respektues të gjërave
hyjnore
zgjohuni nga gjumi i thellë i padijes
mësoni gjuhën romeike, nënë e dijes!

Me *Τὰ θεῖα* duhen kuptuar, thellësisht, udhëzimet e fesë greko-ortodokse. Dhe është interesante të vërehet se pikërisht të përmendurit e faktorit fetar – dhe domethënë e aderimit në fenë ortodokse – ka qenë përgjatë moteve elementi i përdorur nga politika e disa qeverive të ndryshme greke kundrejt pakicave etniko-gjuhësore të pranishme brenda kufijve të vendit. Të gjithë ata që e njihnin veten si të besimit ortodoks, ishin automatikisht

135 Rreth politikës gjuhësore të intelektualëve romeikë kundrejt popullatave ballkanike jugore, krhs. E. BANFI, *La situazione linguistica nella Grecia del secolo XVIII: problemi ed elementi d'analisi*, «Rendiconti dell'Accademia dei Lincei», 33 (1978), ff. 407-429; E. BANFI, *La sostanziale balcanizzazione del territorio romeico e della lingua neogreca*, Milano 1985.

të përkufizuar si 'Ελληνες në kuptimin e plotë dhe diversiteti dhe veçoritë e tyre gjuhësore... thjesht 'të shkrija' brenda detit të gjerë të grekërisë. Si pasojë, e vetmja bashkësi etniko-gjuhësore e njohur zyrtarisht në Greqi sot, është ajo turke dhe kjo njohje ka ndodhur në bazë të Traktatit të Versajës, (viti 1923).

7. Një e ftuar e fundit në banketin e gjuhëve në zonën adriatiko-lindore, ose më saktësisht, në zonën istriane dhe në zonën dalmate, është gjermanishtja e përhapur nga administrata perandorake austro-hungareze. Ursini¹³⁶ vë në dukje se sado që për një shekull ishin të Austrisë, nuk pati kurrë një gjermanizim të provincave juliano-dalmate, megjithëse u përjetuan kohë të një centralizimi burokratik të skajshëm. Një pikë e fortë për gjermanizimin e mjedisit juliano-dalmat ishte sistemi shkollor, i cili impononte gjuhën gjermane si gjuhë arsimit, por në mënyrë që të modifikohet në mënyrë të qëndrueshme panorama socio-gjuhësore e kësaj zone, fatit të gjermanishtes i mungonte një mbështetje e fortë demografike dhe territoriale. Prania gjermane përbëhej në fakt, nga grupe nëpunësisht dhe funksionarësh shtetërorë të cilët – sikurse ndodh rëndom në raste të ngjashme ende sot – çonin një jetë të veçantë dhe që karakterizohej nga disa pak elemente marrëdhëniesh me popullsinë vendase. Disa elemente të jetës ushtarake, të jetës shkollore dhe të administratës hynë në leksikun e përbashkët (*befël* "qortim i ashpër" < td. *Befehl* "urdhër"; *cùfer* "baule" < td. *Koffer/Kuffer* "valixhe."; *mars* "marsh, ik!" < td. *marsch!*; *zàfrestai* "shkëputja e së shtunës në darkë" < td. *Zapfenstreich* "shenja e tërheqjes"; *blifàda* "djersja e derdhur mbi libra" < td. *büffeln* "lodhje e madhe", *teca* "fletore" < td. *Theke* "po ashtu"; *tus* "bojë shkrimi" < td. vjeneze *Tusch* "po aty"; *fènico* "qindarkë e markës" < td. *Pfenning* "po ashtu"; *graziàl* "ndihmë shtetërore" < td. *Gratìal* "koncesion qeveritar"; *placato* "pllakatë" < td. *Plakat* "po ashtu", etj.). Përpos këtyre elementeve, nuk munguan, dhe kjo vërehet, as huazimet e marra nga kuzhina, një aspekt i jetës shoqërore i cili lidhte zonën e Evropës Qendrore ndërmjet tetëqindëshit dhe nëntëqindëshit (*paprika*, *palaçinka* etj.)

8. Një *exemplum* i sintezës

Vepra *Scintille* - Shkëndijat e Niccolò Tommaseo-ut, është e një interesi të jashtëzakonshëm kulturor dhe gjuhësor dhe përfaqëson – për nga pasuria e materialeve që janë depozituar aty – një reflektim të madh emblematik të gjendjes së ndërlikuar gjuhësore në zonën adriatikase në gjysmën e parë të shek. XIX: periudha kohore menjëherë pas kalimit nga *ancien régime* (fundi i shek. XVIII) dhe dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIX.

136 URSINI, *L'identità veneto-dalmata*, f. 91-92.

8.1. Bruni¹³⁷ nënvizon me të drejtë shumëgjuhësinë e theksuar të *Scintille*, rezultat i kushteve gjuhësore dhe kulturore padyshim të jashtëzakonshme të Tommaseo po jo të rralla të dalmatët e tjerë të kohës së tij. Në *Memorie poetiche*, botuar në 1838, vetë Tommaseo kujton se, si student i ri në Padovë në 1822, dinte të vjershëronte italisht, frëngjisht, latinisht dhe greqisht «me pothuajse të njëjtën dashuri në të katërta [...]» (Po aty, f. 80), dhe pak më vonë, po përgatitej të shkruante në një gjuhë të pestë, në ilirisht, gjë që iu ndalua nga censura.

Me ‘ilirisht’, Tommaseo kuptonte përgjithësisht elementin sllav jugor, që ai vetë e kishte përkufizuar nganjëherë si ‘serbico’ ose ‘croatico’, fjalë që me të drejtë Bruni¹³⁸, na fton t’i konsiderojmë jo të përputhshme me «domethënieën e sotme ose me atë që ishte në fuqi në kohën e Jugosllavisë duke qenë se Tommaseo i përdori kur shtetet të cilat i dhanë, ose i japin sot një trup juridik dhe substancë politike atyre formimeve, nuk kishin ndodhur ende.» Dhe se, përkundrazi, termat për të cilët po diskutohet janë përdorur nga Tommaseo me «[...] ndërkëmbim terminologjik, pa dallime të theksuara domethënieje».

Ivetić¹³⁹ e ka shqyrtuar pastaj me vëmendje udhëtimin e Tommaseo-ut drejt gjuhës ‘ilirike’, gjuhë «që ishte e s’ëmës» dhe, nëpërmjet gjuhës, Ivetić ka ndjekur rrugëtimin e Tommaseo-ut drejt atdheut dalmat, atij atdheu, i cili kuptuar pak në mënyrë shkollore si «klasik dhe klasicist, roman dhe venedikas», iu shfaqte si

pararoja e asaj bote sllave të cilën iu dha mundësia ta kuptonte kur ishte në Paris, duke marrë e dhënë me shumë mërgimtarë, dhe së cilës, për shkak të miqësisë me serbin dalmat Spiro Popović, tashti mund t’i afrohej duke folur e duke shkruar në ilirisht.

Zbulimi i ‘Dalmacisë tjetër’ dhe i iliricitetit e bënë Tommaseo-un që të shihte si i hapeshin para

dyert e Sllavërisë [...]. Jo më i huaj falë nënës së tij sllave, ai e ndjente se mund t’iu fliste me zë të lartë sllavëve, ‘vëllezërve’ të gjuhës që banonin në Dalmaci, në Bosnje, në Kroaci, në Serbi dhe në Mal të Zi.

Kështu, në ndonjë çast entuziazmi Tommaseo arriti ta quante veten ‘sllav’, bir i një toke njerëzit e së cilës «i dukeshin të fortë dhe të pastër, sepse ishin afër me etikën klasike dhe biblike dhe nuk ishin ende të prishur nga të metat e kohës moderne.» Një botë sllave e cila nuk i ishte kundërvënë Dalmacisë së tij, ngjyimeve italiane dhe shoqërisë urbane por, përkundrazi, ishte në simbiozë dhe në përputhje të plotë me përvojën personale të

137 F. BRUNI, *Introduzione* në N. TOMMASEO, *Scintille*, nën kujdesin e F. BRUNI, Parma 2008, f. XVI.

138 Po aty, f. XIX.

139 E. IVETIĆ, *Interpretazione delle ‘Iskrice’*, në N. Tommaseo, *Scintille*, nën kujdesin e F. BRUNI, Parma 2008, f. 657-658.

dalmatit të madh, πρωτοπόρος të asaj aradheje të madhe studiuesish të Sllavërisë ballkanike që, me shkencën e tyre, iu kanë ilustruar edhe vetë italianëve të fshehtat e gjuhës së Alighierit.

**U përkthye në gjuhën shqipe
nga Blerina Suta dhe Arben Ndreca.**

**Përkthimi u rishikua nga Migena Shyti Kapllani,
të cilën e falenderojmë.**

V.O. Ky kontributi i prof. Emanuele Banfi është botuar së pari në gjuhën italiane me titull: *Dinamiche linguistiche nell'area adriatica tra i secc. XVIII-XIX: tra diglossie, bilinguismi e ricerca di lingue nazionali*, in Francesco Bruni / Chryssa Maltezou (a cura di), *Atti del Convegno internazionale / Διεθνές Συνέδριο L'Adriatico: incontri e separazioni (XVIII-XIX secolo) / Η Αδριατική: Συγκλείσεις και αποκλείσεις (18ος-19ος αι.)*, Kerkyra, 29-30 aprile 2010/29-30 Απριλίου 2010, Venezia-Atene, Istituto Veneto di Scienze, Lettere e Arti, Istituto Ellenico di Studi Bizantini e Postbizantini di Venezia, Università dello Ionio (Corfù), pp. 39-93.
Botohet në gjuhën shqipe me autorizimin e autorit dhe me lejen e Istituto Veneto di Scienze, Lettere e Arti.